

**AKADEMIA E SHKENCAVE
QËNDRA E STUDIMEVE GJEOGRAFIKE**

ARQILE BËRXHOLI

**REGJISTRIMET E PËRGJITHSHME TË
POPULLSISË NË SHQIPËRI**

(VËSHTRIM HISTORIK)

Tiranë, 2000

**AKADEMIA E SHKENCAVE
QËNDRA E STUDIMEVE GJEOGRAFIKE**

ARQILE BËRXHOLI

**REGJISTRIMET E PËRGJITHSHME TË
POPULLSISË NË SHQIPËRI**

(VËSHTRIM HISTORIK)

Tiranë, 2000

RECEZENT

Prof. Dr. Vladimir Misja
Prof. Dr. Ylli Vejsiu

Formati : 61 x 86 / 16 Tirazhi : 200 copë

*Shtypur në shtypshkronjën e
Institutit Hidrometeorologjik, Tiranë*

**KËTË LIBËR UA KUSHTOJ BREZAVE TË
PUNONJËSVE TË STATISTIKËS, TË CILËT ME
PUNËN E TYRE TË HESHTUR E TE
VAZHDUESHME KANË KRIJUAR MINIERËN E
PAÇMUAR TË FONDIT ARKIVOR TË
STATISTIKËS.**

AUTORI

PARATHËNIE

Statistika demografike është e shumëllojshme dhe sigurohet nëpërmjet burimeve nga më të ndryshmet, si : vlerësimet; anketimet; të dhëna të tjera direkte dhe indirekte etj. Në tërësinë e këtyre burimeve të informacionit statistiko – demografik vend qëndror zë ai që quhet : “Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë”, i cili përfaqëson një proces tepër të veçantë. Këto regjistrime, sot janë bërë një dukuri e rëndomtë periodike në rëlevimin sasior, cilësor dhe strukturor të dukurive demografike. Por ku dhe kur ka filluar të përdoret ky burim informacioni; cila është historia e kalimit në vendin tonë ?

Këtyre pyetjeve synon t’u përgjigjet studimi: “ *Mbi historinë e regjistrimeve të popullsisë në Shqipëri*”

Studimi pas një hyrje të shkurtër për zanafillën e procesit të regjistrimit të popullsisë dhe evolucionin e tij në vende të ndryshme të Evropës bën objekt të vetin, lindjen e procesit të regjistrimit të popullsisë në Shqipëri, aspektin ligjor të organizimit të tij, treguesit e rëlevuar gjatë momentit kritik, metodikën e përdorur gjatë rëlevimit në terren dhe përpunimit statistikor, si dhe disa nga treguesit më të përgjithshëm të çdo regjistrimi.

Më së shumti, studimi është mbështetur në konsultimin e materialit arkivor për një interval kohor tepër të gjatë (1921 – 1990), si dhe të burimeve të tjera vendase e të huaja. Ky studim është një prezantim fillestar i kalimit historik të “*Regjistrimit të popullsisë*”, i cili në vazhdimësi është i nevojshëm të bashkëpërcillet me studime të tjera tematike.

Përpara se të kalojmë në shtjellimin e objektit të studimit në fjalë, më duket me vlerë të shkruaj diçka lidhur me përmbajtjen e “Regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë” si koncept, elementët përbërës dhe treguesit e tij.

Numri i përgjithshëm i popullsisë, struktura cilësore e tij, si dhe treguesit e tjerë numerikë të saktësuar, janë tregues statistikorë, të cilët përfitohen nga “Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë”. Duhet nënvizuar së këta janë tregues momentalë, por periodiciteti i tyre në kushte objektive e subjektive të njëjta, lejon vlerësimin e besueshëm për dinamikën e pritshme.

Regjistrimi i popullsisë shpreh momentin e situatës statistikore të popullsisë së një vendi, i cili ndryshe quhet edhe momenti kritik. Momenti kritik i regjistrimit quhet ora “zero” e një date të caktuar, tej së cilës nuk pasqyrohen ndryshimet statistikore të popullsisë. Çdo rregjistrim i mbyllur (me ndalim qarkullimi) apo i hapur (me lejim qarkullimi dhe afatgjatë në proces), ka një datë dhe moment kritik të fiksuar. Kështu p.sh në regjistrimin e popullsisë në vitin 1945 (rregjistrim i mbyllur) datë fikse dhe moment kritik ishte 30 shtatori dhe ora “zero” e fillimit të kësaj dite. Në regjistrimin e vitit 1979 (regjistrim i hapur) datë fikse dhe moment kritik ishin 7 janari dhe ora “zero” e kësaj dite. Ky element i rregjistrimit të popullsisë përcaktohet paraprakisht, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm. Perkufizohet në mënyrë të prerë e të qartë metodika e punës për realizimin e regjistrimit, metodologjia, si dhe treguesit që do rëlevohen. Për rëlevim sa më korrekt të treguesve

dhe për mundësimin e përpunimit të dobishëm të të dhënave më vonë, është e nevojshme të përkufizohet saktë elementi "popullsi" e hapësirës së caktuar gjeografike apo administrative, në të cilën do të kryhet regjistrimi.

Dy janë treguesit tradicionale dhe themelorë: popullsi banuese dhe popullsi e pranishme. Më tej këto përkufizohen në: popullsi banuese prezente dhe popullsi banuese në mungesë; popullsi e pranishme (prezente, e përhershme dhe popullsi e pranishme e përkohshme).

Jo rrallë jepet edhe koncepti popullsi e përgjithshme, i cili në kushtet e një popullsie të mbyllur (pa migrim) vlerësohet i njëjtë me popullsinë banuese, ndërsa në kushtet e një popullsie të hapur (me migrim) vlerësohet i njëjtë me popullsinë prezente.

Popullsi banuese në regjistrim vlerësohen të gjithë banorët që realisht dhe zyrtarisht kanë vendbanimin e përhershëm në një qendër të caktuar. Popullsi banuese prezente është ajo pjesë e popullsisë që regjistrimi e gjeti në vendin e vet, ndërsa popullsi banuese në mungesë është ajo pjesë e popullsisë që regjistrimi nuk e gjeti në vendin e vet për arsye të ndryshme (shërbime, studime, probleme familjare etj.). Popullsi prezente vlerësohet në regjistrim numri i gjithë banorëve që regjistrimi i gjeti në qendrën e caktuar të banimit, pavarësisht nëse kanë këtu apo jo, vendbanimin e përhershëm. Popullsi prezente e përkohshme konsiderohen të gjithë banorët që regjistrimi i gjeti në vendbanimin konkret, por që nuk e kanë këtu vendbanimin zyrtar. Kjo lloj popullsie prezente mund të jetë afatgjatë (studentë, ushtarë, të burgosur, të punësuar përkohësisht etj.), afatshkurtër (shërbime, pushime, të sëmurë etj.) ose dhe ditorë (kryesisht vizitorë dhe nënpunës të ndryshëm).

Të gjithë këta elementë është e mira që të pasqyrohen në regjistrim, mbasi ndihmojnë në përlogaritjen e shumë treguesve të njohur socialo – ekonomikë, sidomos për prognozën.

Po aq i rëndësishëm është edhe përkufizimi i elementit familje dhe të lidhjeve familjare midis personave, si dhe i deklaramit të etnisë.

Përkufizimi në shtete e situata socialo – ekonomike është i ndryshëm e i evolueshëm.

Përmbahen parasysh shumë rrethana dhe precizimi i konceptit bëhet shumë më para kohës të veprimtarisë konkrete të regjistrimit. Lidhur me deklaramin e identitetit etnik, po ashtu lind nevoja e përcaktimit të qartë të kriterëve bazë, për të cilët ka dhe rekomandime e sygjerime në rang ndërshtetëror. Në përgjithësi për deklaramin e etnisë vlerësohen këta elementë :

- deklarami i individit
- dokumentimi prej regjistrave themeltarë të shtetasve
- etnia e prindërve
- gjuha e folur nga individit në fëmijërinë e hershme
- gjuha që flitet me shumë në familje
- feja, zakonet, traditat etj, si elemente ndihmëse

Deklaramin e vet individit, studiuesit demografikë, përgjithësisht e vlerësojnë si element abuziv. Për të patur një vlerësim real është e nevojshme, kjo është edhe praktika e shumë vendeve, të pasqyrohet në fletën – individuale edhe gjuha amtare sipas kriterëve të mësipërme. Në këtë mënyrë do të mundësohet evidentimi real i

gjithë etnive që përbëjnë popullsinë e vendit dhe njëherësh nuk u lihet vend spekulimeve të ndryshme apo mërive brenda vendit apo në marrëdhëniet me jashtë.

Lidhur me regjistrimet e popullsisë të realizuara në Shqipëri, mund të themi se janë formuluar e kryer mbi baza metodike, metodologjike e kërkesa pothuaj si dhe në vendet e tjera, duke u përsosur në mënyrë të vazhdueshme. Megjithatë disa dukuri kanë cënuar efektivitetin e tyre. Përpupimi i tyre ka vazhduar tepër gjatë, çka ndikoi edhe në kufizimin e vlerave praktike. Formulimi i kërkesave nuk shpëtoi dot nga ideologjizimi e politizimi tërësor i shoqërisë shqiptare, si : struktura klasore, sociale etj, për të propaganduar fitoret e socializmit. Por nje e metë serioze ka qënë mospublikimi i tyre, bile moslejimi i përdorimit as nga studiuesit. Rezultatet e regjistrimeve ishin të mundshëm për tu konsultuar vetëm nga një rreth i kufizuar politikanësh apo pushtetarësh. Publike bëheshin vetëm elementët "ekzaltues" si : zhvillimi i arsimit, shëndetësisë, riprodhimi i shpejtë natyror i popullsisë, fuqizimi i "klasës punëtore" etj. I vetmi publikim masiv u bë në vitin 1991, pas ndryshimeve politike, lidhur me regjistrimin e vitit 1989. Nga sa thamë më sipër mendojmë se studimi do të ndihmojë në njohjen e historisë së regjistrimeve të popullsisë, por edhe si një ndihmesë në ndërmarrje të tilla në të ardhmen.

AUTORI

Si çdo dukuri tjetër e planetit tonë edhe njeriu si individ apo dhe popullata njerëzore si grupim shoqëror, kanë historinë e tyre të evolimit, e cila zë fill qysh me shfaqen e tyre në tokë.

Gjatë këtij evolimi, që rëndom quhet edhe kalimi paleodemografik, erdhi një kohë kur vet njerëzve ju tërhoq vemendja nga dukuritë e këtij evolimi.

Interesi rritej gjithnjë e më shumë me kalimin e kohës aq sa organizmat shtetërore e vlerësuan të domosdoshme njohjen e situatës demografike të vendit e veçanërisht të numrit të popullsisë. Kështu u kalua në një formë të organizuar e periodike të rilevimit të numrit të popullsisë, në "Regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë" si formë e rilevimit tërësor në një moment të caktuar, në atë që tashmë quhet "moment kritik"

Vështrim i shkurtër i historisë së regjistrimeve të popullsisë në Evropë

Sipas pikëpamjes së studiuesve të ndryshëm, që janë marrë me vlerësimin historik të burimeve demografike, historia e regjistrimeve të popullsisë në Evropë¹ fillon nga fundi i shek XVII, ndoshta dhe më herët, me regjistrat kishtarë të dukurive demografike. Në fillim të shek.XVIII, u kalua në organizimin e regjistrimeve administrative, të cilët në literaturën e sotme demografike emërtohen "revizione" që do të thotë kontroll i gjendjes së numrit të popullsisë.

Kalimi në organizmin e "revizioneve" u bë nevojë e kohës për disa arsye :

1.Statistika kishtarë, si rregull vlerësonte numrin e lindjeve, vdekjeve dhe martesave.

2.Zhvillimi i tregtisë, industrisë, zgjerimi i aparatit ekonomik e fenomene të tjerë shtuan domosdoshmërinë e njohjes më të thellë të evolimit demografik, veçanërisht të numrit të popullsisë, përbërjes strukturore dhe migrimit.

3.Formimi i shteteve unike, njëkohësisht kërkonte dhe një statistikë mbarështetërore për popullsinë.

Këto "revizione" fillimisht numurin e përgjithshëm të popullsisë e përcaktonin nëpërmjet rrugëve të terthorta duke përdorur si statistikën kishtarë dhe atë të "revizionit" për numrin e shtëpive. Nismëtare të një përlllogaritje të tillë janë Franca, Austria, Prusia etj. Sipas kësaj mënyre në vitin 1703 numri i banorëve në Bohemi u vlerësua në 2 128 300 banorë, në Moravi 930 000 banorë, Silezi 176 500 banorë.

Mesatarja e personave për çdo familje në këtë kohë u pranua me 4 individë.

Në Suedi, Finlandë, Norvegji, deri në fund të shek.XVIII popullsia tërësore llogaritej mbështetur në statistikën kishtarë, e cila ishte e organizuar shumë mirë.

•Me termin *popullsi* duhet të nenkuptojmë një teresi konkrete njerezish, të cilët popullojnë një hapësirë të caktuar pavarësisht nga permasat e kësaj hapësire dhe të lidhjeve e mardhenieve të ndërtuara midis njerzve.

Kjo teresi njerezish dallohet per dukuri te jashtme dhe te brendshme. Nga ana tjetër çdo pjestar i teresise se njerezve dallohet per individualitetin e tij karakteristik.

Revizioni i parë pilot për popullsinë u organizua në Brandenburg në 1701, që më vonë u pasua nga revizione të përgjithshme si më : 1713, 1725, 1740, 1755. Në Pomerani revizioni që përfshiu gjithë popullsinë u realizua më 1784, në Saksoni në 1746, në Vütemberg në 1734, në Braunshvig më 1760. Revizionet e realizuara në hapsirën gjermanike për nga cilësia ishin afër kërkesave të regjistrimit shkencor. Programi i këtyre revizioneve përmbante : emrin, mbiemrin e individit, gjendjen familjare, rendin social, moshën dhe seksin. Gjendja etnike, si rregull me përjashtim të çifutëve, nuk përfshihej në revizion. Nga përpunimi i materialit theksoheshin hapsirat e populluara nga gjermanët, lituanëzët e polakët në Prusinë Lindore, francezët në Bavari etj por nuk jepeshin tregues sasiorë.

Revizioni i parë i përgjithshëm në Danimarkë u krye në vitin 1769, në Hollandë 1795, në Spanjë 1768, në Francë 1762, në Portugali 1768.

Në perandorinë shumëkombëshe të Austrisë revizioni i parë i përgjithshëm u realizua në vitin 1754. Në këto vende revizionet nuk ishin aq të gjërë si në Gjermani.

Në programin e tyre ato përmbanin vetëm emrin, mbiemrin, seksin, gjendjen familjare, moshën.

Perandoria Austriake, në dallim nga vendet e tjera, sidomos gjatë sundimit të Josifit II, çdo vit nga muaji mars gjer në muajin maj realizonte revizione të përgjithshme për popullsinë.

Në këtë mënyrë, në mesin e shek.XVIII në shumicën e vendeve të Evropës përfitoheshin të dhëna të plota për numurin e përgjithshëm të banorëve, shpërndarjen hapësinore, përbërjen gjinore, moshore e sociale. Mungesa në këto të dhëna shfaqej në strukturën etnike, të cilat filluan të mbledhen vetëm në fund të shek. XVIII dhe fillim të shek.XIX.

Fillimi i shek. XIX për një sërë vende të Evropës, shënon realizimin e regjistrimeve të përgjithshme shkencore të popullsisë. Në vitet 1800-1801 u realizuan regjistrime të tillë dhe në Francë, Danimarkë, Skoci, Angli, Suedi, Norvegji, Finlandë; në Gjermani një regjistrim i tillë u realizua në 1816, ndërsa në Italinë e unifikuar regjistrimi i parë u krye në vitin 1861.

Për vendet e Evropës Juglindore, nën Perandorinë Osmane, shek.XIX karakterizohej nga regjistrime të tipit revizion mbështetur me së shumti në llogaritje aproksimative me tregues indirektë, të numrit të popullsisë.

Pas shpalljes së pavarësisë në disa shtete filloi aplikimi i regjistrimeve të përgjithshme : në Bullgari regjistrimi i parë u krye në vitin 1880, në Rumani 1899, në Serbi 1861, Bosnjë-Hercegovinë 1879, Mal të Zi 1864, në Shqipëri 1879 (nga administrata osmane).

Veçori e regjistrimeve të shek. XIX ka qënë rritja e konisderueshme e cilësisë së llogaritjes, u përmirësua organizimi i regjistrimit, metodika, u zgjeruan treguesit e rëlevuar duke kaluar në regjistrime me të vërtetë shkencore dhe me krijimin e "Teorisë së regjistrimit" e cila gjatë shekullit tonë u përsos në mënyrë të jashtëzakonshme.

Hershmëria e regjistrimeve të popullsisë në Shqipëri

Historia e regjistrimeve të popullsisë në trevat shqiptare e ka zanafillën nga mesi i shek.XV, me realizimin e të parit regjistrim kadastral nga administrata e Perandorisë Osmane i quajtur " Regjistrimi i Tokave të Sanxhakut të Shqipërisë".

Ky regjistrim, që si objekt ka patur rëlevimin e familjeve dhe mundësimin e vjeljeve të taksave, filloi në vitin 1431 me urdhër të Sulltanit.

"Sipas vendimit të Padishahut,... i cili është i plotfuqishëm në vullnetin e tij, u fillua me urdhër të tij përpilimi i këtij " Suret-i defer-i" nga Unur Beu dhe u vazhdua të shkruhet prej meje të përlulurit Jusuf në vitin 835" (1432 A.B).²

Regjistrimi përfshiu çdo fshat mbi bazën e të dhënave të vjela në vend, por dhe të të dhënave deklaruar me hamendje, pa shkuar në vend.

Në vitet 1431-1432 u krye regjistrimi në ish Vilajetin e Gjirokastrës, Vajonetes, Kondo Mihos, Krujës si dhe në disa nahije në ish Vilajetin e Balshajve. Gjatë vitit 1485 kryhet regjistrimi në sanxhakun e Shkodrës, në 1571 në sanxhakun e Dukagjinit, më 1566-1574 në sanxhakun e Vuçiternës dhe në vitin 1591 në krahinën e Hoçes.

Gjatë viteve 1582-1591 ribëhen regjistrime kadastrale në sanxhakun e Shkodrës, Dukagjinit, Prizrenit³.

Këto lloj regjistrime kanë vazhduar deri në vitin 1879 kur bëhet i pari regjistrim i popullsisë, gjithmonë nga administrata osmane, në tipin e "revizionit". Ky regjistrim përmblidhte : numrin e popullsisë, familjeve, gjininë, besimin fetar dhe gjuhën e folur.

Regjistrime të tilla u kryen periodikisht deri në vitin 1908.

Pas shpalljes së Shtetit të Pavarur Shqiptar më 28 Nëntor 1912, regjistrimi i parë i përgjithshëm i popullsisë është realizuar në shtator 1923. Disa regjistrime që u ndërmorën nga austriakët apo italianët gjatë Luftës së Parë Botërore ishin të pjesshëm në hapësirë (vetëm në zonën e tyre të pushtimit) dhe si elemente mbeten vetëm në kuadrin e numrit të popullsisë, të familjeve, dhe gjinisë. Pjesërisht pati të dhëna edhe për moshën.

Regjistrimet e popullsisë në Republikën e Shqipërisë në intervalin kohor midis dy luftrave botërore

Me përfundimin e Luftës së Parë Botërore dhe konsolidimin e organizmave administrative të shtetit shqiptar, në vitin 1923 organizohet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë.

Si kohë për realizimin e këtij regjistrimi u vendos muaji shtator, por realisht ky regjistrim si dhe përpunimi i të dhënave të grumbulluara vazhdoi gjatë.

Kohëzgjatja e madhe u kushtëzua nga dy faktorë :

1.Shumë shtetas ishin pa dokument identifikimi.

2.Në përgjithësi nuk kishte të dhëna të sakta dhe për pasojë deklarime reale për moshën e personave.

Mungesa e dokumentave të identifikimit solli si pasojë që : "...njerëzit e fejuar të regjistroheshin si të martuar, si dhe ata që deklarojnë se janë të ndarë, edhe duke mos paraqitur letër vërtetimet zyrtare të zyrave përkatëse, po i regjistronim të ndarë⁴".

Për të zgjidhur problemin e moshave të personave iu la detyrë komisioneve të regjistrimit të popullsisë për ta përcaktuar me parë atë. "Një ndër detyrat që kanë këto komisione është dhe caktimi i moshës, e kjo detyrë është mjaft e rëndë pse është punë e vështirë t'i caktosh dikujt moshën me të pame⁵".

Si rrjedhojë gjatë regjistrimit pati raste, sidomos për gratë e ndara nga burri dhe fëmijët e marrë me vete, që të regjistroheshin dy herë, një herë në familjen e burrit dhe një herë te familja e prindërve.

Kërkesat e regjistrimit të popullsisë të shtatorit 1923 ishin tepër të kufizuara : emri, mbiemri, emri i prindërve, mosha, gjendja civile e besimi. Ky regjistrim përfshiu edhe banesat duke synuar numerimin fizik dhe gjendjen e përgjithshme me cilësimin e banueshme apo e pabanueshme.

Regjistrimi i popullsisë u drejtua dhe u mbikqyr nga organet e xhandarmërisë së asaj kohe.

Metodika e punës në këtë regjistrim ka qënë : vjelja e të dhënave nga pyetjet që i janë bërë direkt individit. Për personat jo prezent janë përgjigjur të afërmit e tyre. Regjistrimi u bë i hapur pa ndalim qarkullimi të personave.

Materiali i vjelë fillimisht u përpunua në njësinë administrative më të ulët (nënprefekturë), rezultatet përmbledhëse të së cilës ju dërguan Prefekturës ku u krye përpunimi në nivelin e kësaj njësie dhe me pas ju dërguan Ministrisë së Brendshme, e cila kreu përpunimin përfundimtar.

Gjatë përpunimit në njësitë administrative më të ulta, aty ku ka patur të tilla, për përpilimin e listave komisionet janë mbështetur edhe në listat e lëna nga austriakët. "Listat e paraqitura – shënohet në një relacion të kohës – janë nxjerrë nga listat e lëna nga austriakët, pasi është bërë njësimi prej xhandarmërisë sipas pyetjeve që janë bërë për të afërmit".

Përfundimi i përpunimit të materialit të regjistrimit u realizua pjesërisht, sipas zonave, nga fundi i vitit 1923 dhe pjesërisht nga fillimi i vitit 1924. Njëherësh përpunimi në njësitë lokale është realizuar me shumë të meta e pasaktësi çka kushtëzoi kthëzgjatjen e përpunimit përfundimtar dhe pasaktësitë në tërësi. Këtë gjë vënë në dukje telegramet e dërguara prefekturave nga Ministria e Brendshme. "Lutemi me postën më të parë të na njoftoni shumën e vërtetë të secilës nënprefekturë, duke i ndarë elementët veç e veç, që kështu të mundemi të përgatitim një statistikë që ti përgjigjet së vërtetës. Telegramet e dërguar gjer tani, asnjëri nuk i përgjigjet tjetrit⁸".

Nga përfundimi i përpunimit të materialit të vjelë gjatë regjistrimit rezultoi në shtator 1923 një popullsi e përgjithshme prej 803 959 banorësh⁹ e vendosur në 143 065 familje. Nga numri i përgjithshëm i popullsisë 127 595 banorë jetonin në vendbanimet qytetare, të vendosur në 26 072 familje dhe 676 364 banorë jetonin në fshat në 116 993¹⁰ familje.

Një dokument arkivor i vitit 1930 paraqet një numër të përgjithshëm të popullsisë të rezultuar nga regjistrimi i vitit 1923 prej 814 380¹¹ banorësh, duke patur një diferencë prej deklarimit të mëparshëm me 10 421 persona. Mesatarja e frymëve për një familje për gjithë vendin rezultoi 5,6 persona, për popullsinë qytetare 4,9 persona dhe atë fshatare 5,8 persona. Sipas njësive të mëdha administrative (prefekturave) numri i pjestarëve për një familje varionte nga 4,3 persona në ish-prefekturën e Durrësit me 6,4 persona në prefekturën e Shkodrës.

Nga përpunimi i materialit për godinat rezultoi një fond i përgjithshëm prej 143 965 godina të cilat nuk u specifikuan sipas funksionit të tyre.

Regjistrimi i vitit 1923 rilevoi si qendra qytetare 21 vendbanime me popullsi nga 417 banorë qyteti i Lezhës dhe 275 banorë qyteti i Tepelenës deri në 21 580 banorë qyteti i Shkodrës dhe 25 598¹² banorë qyteti i Korçës. Qyteti i Tiranës në këtë regjistrim rezultoi me 10 845 banorë.

Në periudhën kohore midis dy luftërave regjistrimi i dytë i popullsisë u krye në vitin 1930, dy vjet pas shpalljes së Mbretërisë Shqiptare dhe 7 vjet pas regjistrimit të parë të përgjithshëm të popullsisë (shtator 1923). Deri në 1930 në statistikën demografike të vendit është punuar me të dhënat e relatuara nga zyrat e gjendjes civile si zyra të varura e të kontrolluara nga Ministria e Brendshme. Këto zyra, megjithëse me saktësi jo rrallë herë të diskutueshme, nëpërmjet ngjarjeve amëzore (lindje, vdekje, martesë) si dhe të regjistrave të ndërrimit të vendbanimit përllëgarisnin popullsinë sipas rangut të njësive administrative, kryesisht në mes e në fund të vitit.

Duke parë se nga veprimet e mëparshme të zyrave të gjendjes civile si dhe të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë më 1923 kishtë pasaktësi dhe mungesë evidentimi të plotë të banorëve¹³ u kerkua realizimi i regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë në vitin 1930. Regjistrimi i vitit 1930 u kerkua nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila do të formonte dhe Komisionin Qëndror ose siç u quajt "Komisioni i Posaçëm".

Ministria e Punëve të Brendshme, nga mesi i vitit 1929, i paraqiti kërkesën Këshillit të Ministrave për nevojën e regjistrimit të popullsisë gjatë muajve prill – maj 1930.

Qëllimi i regjistrimit ishte :

- a. Plotësimi i regjistarve themeltarë të shtetasve
- b. Rilevimi më i plotë i popullsisë së vendit.

Këshilli i Ministrave shqyrtoi në datën 27 korrik 1929 kërkesën për regjistrimin e popullsisë në prill – maj 1930 dhe mori vendimin përkatës. Këshilli i Ministrave nga ana e vet i dërgon Mbretit Zog propozimin nr. 1203 – IV datë 26 gusht 1929 për vendimin e marrë në lidhje me regjistrimin e popullsisë, i cili e deklaroi atë me 7 shtator 1929. Pas aprovimit nga parlamenti Mbreti urdhëroi zbatimin e dekret – ligjit dhe përfshirjen e tij në Kodet e Mbretërisë si ligj me 15 janar 1930.

Ligji i dekretuar dhe i urdhëruar për zbatim përmbante 8 nene, ne të cilët përcaktohej koha, mënyra, kërkesat, pjesmarrësit dhe detyrimet e shtetasve për kryerjen e regjistrimit¹⁴.

Gjatë regjistrimit do të përdorej një fletë model, e cila përmbante pyetjet : emrin, mbiemrin, atësinë, mëmësinë, seksin, relacionin e gjinisë, datëlindjen, vendlindjen, gjendjen civile, gjuhën amtare, gjuhët e tjera që di, banimin e përhershëm, nënshtetësinë, profesionin, aftësinë për shkrim e këndim, besimin, gjendjen trupore, pronësinë, etj.

Për t'i sqaruar këto kërkesa u përgatit nga "Komisioni i Posaçëm" një qarkore shpjeguese e cila u aprovua, si dhe formulari, nga Këshilli i Ministrave.

Sipas nenit 2 të ligjit për regjistrimit të popullsisë të gjithë nënpunësit e shtetit detyroheshin të kryenin detyra të caktuara nga komisionet e regjistrimit.

Neni 4 i ligjit përcaktonte masat ndaj personave që kundërshtonin zbatimin e detyrës ose nuk kryenin regjistrimin e plotë të pjestarëve të familjes së tyre.

Nga pikëpamja e realizimit regjistrimi ishte i hapur, pa ndalim qarkullimi dhe vazhdoi gjatë gjithë muajit maj. Megjithatë si data fikse e regjistrimit u caktua 25 maji i vitit 1930.

Rilevimi i popullsisë gjatë regjistrimit të 25 majit 1930 ishte më korrekt në krahasim me atë të shtatorit 1923, megjithatë edhe këtu pati të meta serioze.

Edhe në këtë regjistrim pika më e dobët ishte rilevimi moshor i popullsisë. Sipas një shkrese të Drejtorisë së Rekrutimit të Prefekturës Shkodër "... 119 persona të regjistruar më 25 maj 1930 nuk ju është caktuar datlindja¹⁵".

Një e metë tepër serioze e regjistrimit ka qënë ajo që krahas gjuhës amtare figuronte dhe kollona "Ditunia", ku kërkohej të jepej përgjigje për gjuhën që dinte me shkrim e këndim çdo individ. Nga përgjigjet e dhëna rezultoi që jo pak persona, sipas shkollës që kishin kryer, deklaruan gjuhë të ndryshme. Studiues të ndryshëm të dhënat e kësaj kollone i kanë keqinterpretuar duke i identifikuar me etnite¹⁶.

Përpunimi përfundimtar i të dhënave nxorri një popullsi të përgjithshme të Mbretërisë Shqiptare prej 833 850 banorësh, duke patur kundrejt mesatares së vitit 1927, një rritje me 232 banorë¹⁷. Burime të tjera të mëvonshme, për regjistrimin e vitit 1930, japin një popullsi të përgjithshme prej 1 003 097 banorësh¹⁸. Një e dhënë tjetër për regjistrimin e vitit 1930 jepet në revistën "Përpyekja Shqiptare", me 968 092 banorë¹⁹.

Nga e gjithë popullsia e vendit, sipas regjistrimit 1930, 182 774 banorë

jetonin në 24 qendra qytetare dhe 651 076 banorë jetonin në fshat. Kundrejt vitit 1923 popullsia tshatare ka tregues me 25 288 banorë me pak, çka duket e dyshimtë.

Në regjistrimin e 25 majit 1930 u bë dhe rilevimi fizik i banesave çka rezultoi një fond prej 187 610 banesash, i paspecifikuar sipas destinacionit. Ky fond banesash rezulton me një numër 43 645 banesa më shumë se viti 1923, që do të thotë çdo vit në Shqipëri në atë kohë ndërtoheshin 6 235 banesa²⁰.

Me pushtimin fashist, në shtator 1940, autoritetet italiane të pushtimit dhe administrata shtetërore shqiptare e kohës u përpoq të kryente një regjistrim të ri të popullsisë.

Pyetjet pothuajse ishin si ato të vitit 1930, përmbledheshin në një fletë modular të vetëm.

Ky regjistrim, për kushtet konkrete të kohës, nuk pati sukses dhe përfundoi në një numërim të përgjithshëm të popullsisë, që më së shumti ishte një mesatare e llogaritur se sa e nxjerrë nga rilevimi direkt.

Po ashtu në vitin 1943, në kushtet e pushtimit gjerman, u bënë përgatitje për organizimin e regjistrimit të ri të popullsisë. Si datë fikse e këtij regjistrimi u caktua 24 tetori 1943.

Dokumentacioni i këtij regjistrimi përbëhej vetëm nga një modular, Mod. A, i përbërë nga dy lista : fletë individuale dhe familjare. Në fletën individuale përfshiheshin 20 pyetje, të cilat kërkonin të dhëna për gjeneralitetin e individit, moshën, vendbanimin, zanatin (profesionin), gjuhën e folur dhe origjinën (e babës, nënës, fisit).

Në realitet një regjistrim i tillë synonte gjithë trevat shqiptare mbetur jashtë trungut të shtetit shqiptar sipas vendimit të Fuqive të Mëdha dhe që iu bashkuan Mbretërisë Shqiptare me pushtimin gjerman. Këtë shpreh dhe titulli i regjistrimit : "Regjistrimi i Popullsisë së Tokave të Lirue...."

Si në regjistrimin e vitit 1930, në atë të vitit 1940 dhe 1943, pyetjet kanë qënë pothuaj të njëjta. Në aspektin metodologjik të përlllogaritjes së numurit të popullsisë, të gjithë modularët e regjistrimit, saktësonin se në regjistrimin e popullsisë nuk pasqyroheshin të gjithë personat që vdisnin deri në orën "0" të datës fikse të regjistrimit, si dhe të gjithë ata që lindnin pas orës "0" të datës fikse të regjistrimit.

Lidhur me grupimin moshor më së shumti merrej parasysh viti i lindjes, megjithëse në modularin individual ekzistonte e pasqyruar dita – muaji – viti i lindjes.

Vlerësuar nga aspekti i elementëve, në regjistrime u përfshi e gjithë popullsia e pranishme edhe të huajt jo shtetas shqiptarë. Për këta kishte një kolonë të veçantë ku shënohej shtetësia e individit.

Regjistrimet e popullsisë në Republikën e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, me konsolidimin e organizmave shtetërore e të organizmit administrativ – tokësor u ndërmorën e u realizuan regjistrime të popullsisë, të cilët kanë patur një metodikë e mënyrë organizimi të caktuar. Prej vitit 1945 e gjer më sot, janë kryer 7 regjistrime të përgjithshme të popullsisë, katër prej të cilave në çdo 5 vjet dhe 3 të fundit për çdo 10 vjet.

Nevoja e regjistrimit

Për çdo regjistrim të popullsisë paraprakisht i është dërguar nga organizmi përkatës (Drejtoria e Statistikës e më vonë Komisioni i Planit të Shtetit) një platformë qeverisë, ku pasqyroheshin : nevoja e kryerjes së regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, metodika përkatëse, modularët, fondet e nevojshme financiare, organizmat që do të angazhoheshin si dhe projekt – vendimi i nevojshëm për tu shndërruar nga Këshilli i Ministrave në vendimin e duhur.

Nga ekzaminimi i relacioneve vihet re se nevoja e regjistrimit, pothuaj për të gjithë regjistrimet e përgjithshme të popullsisë së realizuar, përmbledhej në :

- + Vlerësimin e ndryshimeve në dinamikën demografike;
- + Nevojën e plotësimit të Regjistrave Themeltarë të Shtetasve;
- + Pasqyrimi i evolucionit socio – demografik;
- + Ndjekja më e plotë e procesit të migrimit të brendshëm demografik;
- + Evidentimi i raporteve në ndryshim të popullsisë sipas ndarjes qytet – fshat;
- + Mënjanimi i gabimeve të vërejtura gjatë përpunimit të rëlevimeve të regjistrimit të mëparshëm, sidomos të atyre të realizuar në vitet 1945 – 1955;
- + Vlerësimi i ndryshimeve strukturore, si pasojë e ritmeve realisht të larta të riprodhimit natyror të popullsisë në Shqipëri;
- + Njohja më reale e potencialit demografik sipas njësive administrative, të cilën nuk mund ta pasqyronin realisht Zyrat e Gjendjes Civile, pasi organizimi administrativo – tokësor i vendit ka qënë tepër i paqëndrueshëm, sidomos në nivelin lokal.

Metodologjia

Në realizimin e regjistrimeve të përgjithshme të popullsisë, në vitet 1945-1989 metodologjia e përdorur ka qënë ajo e mëparshme :

- + Njohja e ngjarjeve demografike deri në orën “0” të datës fikse të

njohur me vendim të organizmave më të larta të pushtetit legjislativ apo organizativ;

- + Në të dhënat për moshat, sipas grupimeve, është kërkuar rilevimi i vitit, muajit ose edhe i ditës;
- + Përpunimi i elementëve të rilevuar iu nënshtrua jo pak elementeve politizues e ideologjizues, sidomos në regjistrimin e vitit 1969.

Metodika e punës

Realizimi i regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë u parapri nga puna parapërgatitore si:

- + Ndarja hierarkike e hapësirës së vendit për të realizuar regjistrimin;
- + Përgatitja e dokumentacionit bazë, informativ dhe shpjegues (modularët, shpalljet, udhëzuesit);
- + U ngritën grupet e punës duke përcaktuar dhe raportet midis tyre në drejtim vertikal apo horizontal;
- + U përcaktua mënyra e realizimit të regjistrimit (me ndalim qarkullimi ose i lirë);
- + U saktësua edhe mënyra e rilevimit, nëpërmjet deklarimit direkt të personit, para nëpunësit të regjistrimit, si dhe pajisja e tij me dokumentin e identifikimit individual.

1. Regjistrimi i vitit 1945

Kryesia e Këshillit Antifashist NÇL, më datën 15.09.1945 mori vendimin nr.119 "Mbi regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë"²¹. Ky vendim përbëhej nga 6 nene dhe përmbante datën e saktësuar të regjistrimit, qëllimin e regjistrimit, mënyrën e organizimit dhe masat ndaj atyre që kundërshtojnë kryerjen e regjistrimit. Qëllimi i regjistrimit: "... për efekt të zgjedhjeve për Asambleenë Kushtetuese" dhe data e regjistrimit (30 Shtator 1945), fiksohen qysh në nenin 1 të vendimit. Neni dy i vendimit përmbante subjektet dhe personat që do të angazhoheshin në kryerjen e regjistrimit. Me zbatimin e vendimit u mor Këshilli i Ministrave, i cili caktoi Komisionin Qëndror që do të formulonte udhëzimet e domosdoshme për mënyrën e kryerjes së regjistrimit, si dhe do të aprovonte modularët përkatës të paraqitur nga Drejtoria e Statistikës pranë Këshillit të Ministrave, krijuar me vendimin nr.35 datë 13.01.1945 të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar²².

Fillimisht Drejtoria e Statistikës përgatiti "Udhëzimet metodologjike të regjistrimit të popullsisë", të cilat përmbanin:

1. Udhëzime për zyrat dhe nëpunësit e regjistrimit.
2. Udhëzime të përgjithshme

Në Udhëzimet metodologjike flitej për qëllimin e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, mënyrën se si do të drejtohej e realizohej regjistrimi, ndarjen e vendit në zona e sektorë regjistrimi, emërimin e nëpunësve të regjistrimit, masat për ditën fikse të regjistrimit, mënyrën e shpërndarjes së modularëve, normat e përgjithshme, veprimet pas regjistrimit, udhëzimet e veçanta për nëpunësit, e

regjistrimit duke sqaruar edhe përmbajtjen e modularëve dhe mënyrën e plotësimit të tyre.

Paragrafi i parë i "Udhëzimeve metodologjike" jepte më gjerësisht qëllimin e regjistrimit të popullsisë: "Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë bëhet në një datë të caktuar për të njohur gjendjen e saj numerike të ndarë sipas gjinisë, moshës, gjendjes civile, profesionit etj".²³

Në paragrafin 38 të faqes 15 të "Udhëzimeve metodologjike" në lidhje me plotësimin e modularëve theksohej edhe evidencimi i gjuhës amtare: "Në këtë shtyllë do të tregohet gjuha që i regjistruari përdor dhe flet në familjen e tij"²⁴.

1.a. Dokumentet e regjistrimit

Gjatë regjistrimit janë përdorur mod. "A" dhe mod. "B" që bënin pjesë në "Fletën familjare", si dhe Mod. "A" dhe Mod. "B" që bënin pjesë në grupin "Fletë bashkëjetese" trashëguar nga regjistrimet 1930-1943.

Mod. "A" i "Fletë familjare" plotësohej për çdo individ me të dhëna: emri, mbiemri, datëlindja, gjinia, gjendja civile, besimi, gjuha që flet (gjuha amtare A.B), profesioni etj.

Mod. "B" i "Fletë familjare" ishte përmbledhëse e gjithë familjes.

Mod. "A" i "Fletë bashkëjetese" ishte po ashtu fletë individuale e persnave që regjistrimi i zuri në institucione të ndryshme si: konvikte, spitale, shtëpitë e pleqve, burgje etj.. Ky modular kishte po ato të dhëna si dhe modulari "A" i "Fletë familjare".

Mod. "B" e "Fletë bashkëjetese" ishte po ashtu fletë individuale, e cila plotësohej nga personat që kishin lidhje me institucionin e bashkëjetesës (konvikt, spital, Shtëpi e Pleqve, burg etj.), por që ditën e regjistrimit nuk gjendeshin në institucionin e bashkëjetesës.

Mbi bazën e "Fletë familjare" Mod. "B" dhe "Fletë bashkëjetese" u përpilua përmbledhësi i zonës së regjistrimit me Mod.2 dhe më tej u përpilua përmbledhja e nënprefekturës, për të cilën u përdor Mod.3. Gjithë dokumentacioni i regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë u përcoll në Drejtorinë e Statistikës pranë Këshillit të Ministrave, ku u krye përpunimi përfundimtar e tërësor, i cili zgjati pothuajse një vit pune.

Mënyra e realizimit të regjistrimit ishte me ndalim qarkullimi, dhe koha e kryerjes brenda 24 orëve të ditës së përcaktuar. Në shpalljen e publikuar nga Komisioni Qendror i Regjistrimit midis të tjerave theksohej: "U bëhet e ditur banorëve të qytetit dhe të katundeve, se në bazë të vendimit të Këshillit ANCL më 30 shtator 1945, ditë e diel, do të bëhet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë. Regjistrimi do të bëhet brenda një dite. Si pasojë ditën e regjistrimit qarkullimi është i ndaluar kryekëput"²⁵

1.b. Rezultatet më të përgjithshme të regjistrimit

Nga përpunimi i materialit të rilevuar gjatë regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë rezultoi një popullsi tërësore prej 1122044 banorësh²⁶, nga të cilët

570361 vetë ishin të gjinisë mashkullore dhe 551683 vetë të gjinisë femërore. Sipas ndarjes qytet-fshat struktura që rezultoi nga regjistrimi ishte: 238812 banorë jetonin në 24 qendrat qytetare dhe 883232 banorë jetonin në fshat. Qendrat qytetare rezultuan me një popullsi nga 435 banorë, Tepelena gjer në 24602 banorë Korça, 34335 Shkodra dhe 59950 Tirana.

Grupimi sipas frymëve i vendbanimeve rezultoi se 81.2% e numrit të përgjithshëm të vendbanimeve (2679) kishin popullsi gjer në 500 banorë, 14,7% e vendbanimeve kishin popullsi 500-1000 banorë dhe vetëm 4,1% e numrit të vendbanimeve (qytetet kryesisht) kishin popullsi mbi 1000 banorë secili.

Struktura grupmoshore e popullsisë (për të gjithë popullsinë) e vlerësuar nga regjistrimi ishte:

- * gjer në 15 vjeç kishte 444205 banorë ose 39,6% e popullsisë së përgjithshme
- * 15 - 59 vjeç kishte 555412 banorë ose 49,5% e popullsisë së përgjithshme
- * 60 vjeç e lart kishte 122427 ose 10,9%

Nga përpunimi i të dhënave grupmoshore 5 vjeçare të regjistrimit të popullsisë, në vitin 1945 mosha mediane e gjithë popullsisë së vendit rezultoi 20.4 vjeç.

Tregues të tjerë që rilevoi regjistrimi i popullsisë i 30 Shtatorit 1945 ishte niveli i shkollimit dhe kontigjenti i shtetasve shqiptarë me etni jo shqiptarë.

Duke marrë për bazë popullsinë mbi 8 vjeç nga regjistrimi rezultoi se kontigjenti i saj ishte 860316 banorë prej të cilëve vetëm 211851 ose 24,6 %, dinin shkrim e këndim, ndërsa 648465 banorë, ose 75,4%, ishin analfabetë.

Në lidhje me përbërjen etnike të popullsisë²⁷ regjistrimi rilevoi 1075467 shtetas shqiptarë me etni shqiptarë dhe 46577 persona (shtetas shqiptarë ose të huaj) me etni joshqiptarë.

Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë në Shtator 1945 rezultuan gjithsej 196850 familje me mesatarisht 5.7 persona për familje. Nga numri i përgjithshëm i familjeve 48820 familje jetonin në qytet me mesatarisht 4.9 persona secila dhe 148030 familje jetonin në fshat me mesatarisht 6 persona secila.

2. Regjistrimi i vitit 1950

Pas përfundimit të përpunimit të të dhënave të regjistrimit të shtatorit 1945 filloi puna për "Rikrijimin e regjistrave themeltarë të popullsisë" sipas vendimit të Këshillit të Ministrave datë 31.01.1946. Qëllimi i rikrijimit të këtyre regjistrave ishte: "Zëvendësimi i regjistrave themeltarë të vitit 1930 atje ku nga lufta ishin djegur, si dhe për nevoja të pasqyrimin në to të dispozitave të tjera, sidomos të shpërnguljeve e të vendosjeve."

Më vonë, në 5 gusht 1947 me vendimin nr.254 Këshilli i Ministrave aprovoi projekt-ligjin "Mbi regjistrat e gjendjes civile". Projekt-ligji kaloi në Kuvendin Popullor, i cili më datën 19 gusht 1947 me dekretin nr.443 shpalli ligjin nr.524 "mbi regjistrat e gjendjes civile. Ky ligj i shpallur nga Kuvendi Popullor përbëhej nga 7 kapituj dhe 64 nene. Njëkohësisht me 13 mars 1950 aprovohet ligji nr.793²⁸ " mbi organizimin e shërbimit statistikor", i përbërë nga 15 nene, ndërsa me 14.08.1950 Presidiumi

i Kuvendit Popullor nxorri dekretin nr.1131²⁹ për ligjin "Mbi regjistrat themeltarë të shtetasve" me 15 nene. Në nenin 1 të ligjit jepet qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji "Evidencimin e lëvizjes demografike të shtetasve".

Kërkesat ligjore për plotësimin e dokumentimin e situatës demografike nga njëra anë, si dhe vet ndryshimet demografike të ndodhura në vitet 1945-1949 bënë që komisioni i Planit të Shtetit, në fund të vitit 1949, të hartojë raportin analitik drejtuar Këshillit të Ministrave, ku shtrohej dhe argumentohej nevoja e kryerjes së regjistrimit të ri të përgjithshëm të popullsisë. Raporti analitik bashkëshoqërohej edhe me modularët e propozuar nga Komisioni i Planit të Shtetit. Ky raport pasi u diskutua nga të gjithë dikasteret qendrore (ministritë) më 27 mars 1950 diskutohet në mbledhjen e Këshillit të Ministrave i cili më 01.04.1950 nxorri vendimin nr.213 "Mbi regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë" duke caktuar si datë të këtij procesi 1 Tetor 1950, ditë e dielë. Në këtë vendim përcaktohej edhe përbërja e komisionit qendror të regjistrimit ku kryetar caktohej Presidenti i Komisionit të Planit të Shtetit dhe anëtarë përfaqësues, si rregull zv/ministrat, nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë si dhe Drejtoria e Drejtorisë së Statistikës në Komisionin e Planit të Shtetit.

Këshilli i Ministrave me shkresë nr.173/103 datë 22.06.1950 i dërgon Presidiumit të Kuvendit Popullor ligjin nr.424 datë 22.06.1950 "Mbi regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë" për ta dekretuar. Presidiumi i Kuvendit Popullor e shpall atë më 5 orrik 1950 me dekretin nr.1112. Me këtë ligj si datë fikse e regjistrimit u caktua 3 shtatori i vitit 1950. Mënyra e regjistrimit si dhe qëllimi i tij përcaktoheshin qartë në ligjin e aprovuar, i cili përbëhej nga 12 nene.³⁰ Në nenin 1 të ligjit " Mbi regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë thuhej se:

"Duke marrë parasysh se në pesë vjetët e fundit në vendin tonë janë bërë ndryshime të mëdha në përbërjen e popullsisë nga pikpamja numerike, shoqërore, kulturore, profesionale etj., si dhe nevojën e krijimit të një regjistri themeltar të shtetasve më të përsosur, në mënyrë që t'i përgjigjet konditave të sotme, autorizohet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë".³¹

Neni 2 i ligjit autorizonte Komisionin Qendror të Regjistrimit të mbikqyrte dhe drejtonte veprimet për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë. Njëkohësisht urdhëroheshin komisionet e Pushtetit Lokal që gjer më 31 korrik 1950 të kontrollonin dhe plotësonin emërtimin e rrugëve e shesheve.

Mënyra e organizmit të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë përcaktohej në nenin 4 të ligjit ku thuhej se:

"Regjistrimi do të bëhet shtëpi më shtëpi, në prezencë të personave që do të regjistrohen.

Ditën e regjistrimit është i ndaluar qarkullimi. Mund të lëvizin vetëm personat e pajisur me leje të posaçme, të lëshuar nga komisionet e regjistrimit".³²

Mënyrën e regjistrimit të individëve ligji e saktësonte në nenin 6 të tij ku thuhej:

"Të gjithë personat duhet të vërtetojnë përpara nëpunësit të regjistrimit identitetin dhe gjendjen civile të tyre me letër njoftimi ose certifikatë lindje dhe dokumentin ushtarak".³³

2.2. Dokumentet e regjistrimit 1950

Modularët e përdorur në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë më 3 shtator 1950 ishin gjithsej 10 copë të emërtuar me shkronja (A - U).

Mod. "A". Ishte një formular individual, ku do të jepej përgjigje 8 grupe pyetjesh, që u përdor për të rriturit gjer në datëlindjen e vitit 1939.

Mod. "B". Po ashtu ishte formular individual për personat e datëlindjes 1940-1950.

Mod. "C". Fletë familje ku shënoheshin të dhëna për përbërjen familjare dhe raportet e marrëdhënieve midis tyre (burri, gruaja, e bija, i biri etj.).

Mod. "D". Proçesverbali i sektorit për mbylljen e regjistrimit dhe përmbledhësja e sektorit.

Mod. "E". Fletë përmbledhëse e lokalitetit. ³⁴

Mod. "N". Lista e numrit të ndërtesave.

Mod. "S". Lista e sektorëve, në të cilat ishte ndarë njësia administrative përkatëse për efekt regjistrimi të popullsisë.

Mod. "K". Proçesverbal i inspektorit të zonës së regjistrimit dhe lista e nëpunësve pjesëmarrës në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë.

Mod. "R". Listë përcjellëse e kopjes së materialit të regjistrimit për personat që regjistrimin e gjendjes civile e kanë patur jo në vendin ku i gjeti regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë.

Mod. "U". Urdhërshërbimet për nëpunësit e regjistrimit që u aktivizuan në këtë proçes.

Për realizimin e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë më 3 shtator 1950 u kryen 1.8 milionë lekë shpenzime. ³⁵

Përpunimi i të dhënave edhe të këtij regjistrimi vazhdoi pothuajse një vit pune. Fillimisht u deklaruan disa të dhëna të përgjithshme, si: numri i përgjithshëm i banorëve për gjithë vendin apo sipas njësive administrative, përbërjen gjinore, struktura qytet-fshat si dhe numri i përgjithshëm i banesave. Të dhënat e plota të regjistrimit, sidomos ato që shprehin strukturën moshore, përbërjen familjare, kombëtare etj, u deklaruan pas përfundimit tërësor të përpunimit të materialit statistikor të rilevuar.

Mbi bazën e të dhënave të këtij regjistrimi u bë edhe plotësimi i regjistrave themeltare të gjendjes civile, në të cilët u pasqyrua edhe kombësia, e vlerësuar edhe mbi bazën e gjuhës që flitej në shtëpi, sidomos në moshën parashkollore të fëmijëve.

2.b. Rezultatet më të përgjithshme të regjistrimit

Përpunimi përfundimtar i materialit të regjistrimit të popullsisë rezultoi në një popullsi tërësore të vendit prej 1218943 banorësh ³⁶⁾³⁷⁾, prej të cilëve 625935 banorë ishin të gjinisë mashkullore dhe 593008 banorë të gjinisë femërore. Grupuar sipas vendbanimit qytet-fshat, nga regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë rezultoi që 249783 banorë të jetonin në qytet dhe 969160 banorë të jetonin në fshat duke patur një strukturë respektive 20.5% me 79.5%.

Grupimi i vendbanimeve sipas numrit të frymëve evidentoi se: me popullsi gjer në 500 banorë për çdo vendbanim kishte 2046 vendbanime (ose 78%) që kishin gjithsej 542975 banorë ose 44.5% e numrit të popullsisë së përgjithshme).

Me popullsi 500-1000 banorë rezultuan 474 vendbanime (18.1%) dhe 327000 banorë (26.8%). Njëherësh 3.9% e vendbanimeve (102 vendbanime) kishin mbi 1000 banorë. Në këtë kategori vendbanimesh ishte përqëndruar 28.7% e popullsisë (348968 banorë).

Krahasuar me regjistrimin e vitit 1945 popullsia e përgjithshme ishte rritur 8.6% me ritëm mesatar vjetor 1.0167, ndërsa në strukturën sipas vendbanimeve u rrit grupi me mbi 200 banorë, mbi 500 banorë dhe mbi 2000 banorë, kur grupi gjer në 100 banorë ishte pakësuar me 23.3%.

Struktura grupmoshore e popullsisë së vendit e rilevuar nga regjistrimi ishte:

- gjer në 15 vjeç kishte 470362 frymë (ose 38.6%).
- 15 gjer në 59 vjeç kishte 634760 frymë (ose 52.1%)
- mbi 60 vjeç kishte 113821 frymë (ose 9.3%).

Sipas të dhënave grupmoshore 5 vjeçare të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë më 3 shtator 1950 vihet re se mosha mediane ishte 20 vjeç, duke u ulur me 0,4 vjeç ndaj asaj të rilevuar në 30 shtator 1945, rrjedhje kjo e shtimit të lindjeve në gati dyfishimin e tyre.

Lidhur me përkatësinë kombëtare regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë më 3 Shtator 1950 rilevoi 1183742 banorë shtetas shqiptarë, me kombësi shqiptare dhe 35201 banorë me kombësi jo shqiptare.³⁸

Rënia e numrit të popullsisë me kombësi jo shqiptare më 1950 kundrejt 1945, sipas analizës përkatëse të kohës, ³⁹ ka ndodhur pasi gjatë viteve 1945-1950 janë riatdhesuar mbi 2700 italianë dhe 11000 jugosllavë të ardhur gjatë luftës. Numri i përgjithshëm i familjeve të rezultuara nga regjistrimi ishin 211613 me mesatarisht 5.8 persona për një familje, të cilët lëkunden nga 5.1 persona në Tiranë e Gjirokastrë, në 6.6 persona në Berat. ⁴⁰ Sipas ndarjes qytet-fshat nga regjistrimi rezultuan: në qytet 53686 familje me mesatarisht 4.7 persona dhe në fshat 157929 familje me mesatarisht 6.1 persona.

Situata e shkollimit nga regjistrimi rezultoi e tillë ku në popullsinë mbi 8 vjeç prej 954486 frymë, 513716 persona (ose 53.8%) ishin analfabetë. Treguesi i analfabetizmit sipas gjinisë ishte: për meshkujt 41.2%, ndërsa për femrat 67%.⁴¹

3. Regjistrimi i vitit 1955

Ndryshimet e shpejta në evolucionin demografik të vendit si dhe pamundësia për t'i ndjekur dukuritë demografike nëpërmjet një statistikë korente e të vlerëshme, pas një periudhë kohore 5 vjeçare u shtrua nevoja e një regjistrimi të ri të përgjithshëm të popullsisë. Për këtë, në fillim të vitit 1955, Drejtoria e Statistikës në Komisionin e Planit të Shtetit përgatiti materialin në formën e një projekt-vendimi ku trajtoheshin:

- Evolucioni demografik pas vitit 1950;
- Justifikimi për kryerjen e një regjistrimi të ri të përgjithshëm të popullsisë;

- Përcaktimi i datës së mundëshme të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, në 4 shtator 1955;
- Kohën e ngritjes së komisioneve të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë në njësitë administrative (rrethe);
- Shpenzimet e nevojshme finaciare.

Materiali, në formën e projekt-vendimit, bashkëshoqërohej edhe me relacionet përkatëse dhe maketet e fletëmodularëve të mundshëm që do të përdorehin në regjistrimin e pritshëm.

Projekt-vendimin me të gjithë materialet bashkëshoqëruese, me shkresën nr.90 datë 24.02.1955, Komisioni i Planit të Shtetit jia dërgon Këshillit të Ministrave për të marrë aprovimin e duhur.

Pas njohjes së të gjithë dikastereve me materialin, Këshilli i Ministrave këtë projekt-vendim e mori në shqyrtim më datën 31 maj 1955 dhe në po këtë datë nxori vendimin nr.182 që aprovonte kërkesën e Komisionit të Planit të Shtetit. Në mbledhjen e 31 majit Këshilli i Ministrave aprovoi si datë të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë ditën e dielë 4 shtator 1955 . Në këtë mbledhje të Këshillit të Ministrave, ku u aprovuan edhe modularët me përmbajtjen e tyre, u kërkuar që në fletën individuale të shënohej edhe emri i nënës dhe besimi fetar. Më vonë, në variantin përfundimtar, nga fleta individuale u mënjantuan pyetja mbi besimin fetar.

Vendimin e aprovuar Këshilli i Ministrave ja dërgon Komisionit të Planit të Shtetit, i cili të fillonte menjëherë nga puna. Problemet e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë Këshilli i Ministrave i mori në shqyrtim edhe në mbledhjen e datës 06.07.1955 dhe me vendim nr.950, datë 13.07.1955, cakton si datë të regjistrimit të popullsisë 2 Tetorin 1955, po ditën e diel.

Kjo datë është inkluduar në vendimin nr.182 datë 31.05.1955, kur u botua (në muajin gusht) në gazetën zyrtare. 42

Vendimi i Këshillit të Ministrave 'Mbi regjistrimin e popullsisë' përmbante 10 nene.

Në fillim të vendimit pasqyrohej qëllimi, për të cilën realizohej regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë: "Këshilli i Ministrave ... duke marrë parasysh se gjatë pesë vjetëve të fundit ... është ndryshuar përbërja e popullsisë ... dhe nga ana tjetër, duke marrë parasysh se shërbimi i sotëm demografik nuk u përgjigjet kërkesave të planifikimit; me qëllim që të dalë i saktë përcaktimi numerik i popullsisë dhe të krijohet një bazë e shëndoshë për ndjekjen e lëvizjes së popullsisë me evidencë korente në të ardhmen, vendosi të bëhet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në të gjithë territorin e Republikës". 43

Neni 1 i vendimit përmbante datën e rishikuar të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, 2 tetor 1955, ditën e dielë.

Neni 2 aprovonte ngritjen e Komisionit Qëndror të regjistrimit të përbërë nga:

Presidenti i Komisionit të Planit të Shtetit	Kryetar
Zv/Presidenti	" " " Anëtar
Zv/Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar
Zv/Ministri i Mbrojtjes Popullore	Anëtar
Zv/Ministri i Arsimit-Kulturës	Anëtar

Po ashtu në këtë nen përcaktoheshin njësitë administrative që sipas rangut do të ngrinin komisionet e regjistrimit si dhe organizmat që kishin në kompetencë aprovimin e komisioneve të hallkave të ndryshme; kështu Komisioni Qëndror aprovonte përbërjen e komisioneve të qarqeve, komisionet e rretheve aprovoheshin nga ai i qarkut dhe komisionet e fshatrave, qyteteve apo lagjeve të qyteteve aprovoheshin nga komisioni i rrethit⁴⁴. Neni 3 i vendimit përcaktonte si datë limit 15.08.1955 për kontrollin dhe plotësimin e emërtimit të rrugëve si dhe numërimin dhe regjistrimin e ndërtesave.

Nenet 4,5,6 të vendimit përcaktonin mënyrën e caktimit të nëpunësve të regjistrimit dhe të inspektorëve të zonës, organizmat që i emëronin ata, detyrimet e tyre, mënyrën e regjistrimit të shtetasve që regjistrimi do t'i gjente jashtë kufinjve të vendit, masat ndaj atyre që kundërshtonin t'u përgjigjeshin nëpunësve të regjistrimit ose ndaj atyre nëpunësve që nuk kryenin detyrën.

Neni 7 përcaktonte fondin monetar të venë në dispozicion të Komisionit Qëndror për regjistrimin e popullsisë. Ky fond ishte 3.5 milionë lekë dhe për komisionet e qarqeve ishte 500 mijë lekë.⁴⁵

Neni 9 i vendimit i jepte të drejtën Komisionit Qëndror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë, që për mbarëvajtjen e procesit të regjistrimit të nxjerrë "udhëzime të detyrueshme".

Konformë vendimit nr.182 datë 31.05.1955, veçanërisht në zbatim të nenit 9 të këtij vendimi, Komisioni Qëndror i Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë më 3 shtator 1955 nxori urdhërin e firmuar nga kryetari i këtij komisioni, ku midis të tjerave theksohej edhe mënyra e kryerjes së regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë. Për të njohur popullsinë me këtë procedurë Komisioni Qëndror aprovoi dhe publikoi "Shpalljen" përkatëse, "Udhëzuesit metodologjike" për regjistrimin e popullsisë, si dhe detyrat e komisioneve të hallkave të veçanta gjatë e pas procesit të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë.

3.a. Udhëzuesit metodologjikë-përmbajtja e tyre

Udhëzuesit metodologjikë përbëheshin nga dy broshura, prej të cilave njëra ishte me udhëzime për punonjësit e regjistrimit dhe tjetra me udhëzime të përgjithshme.

Në "Udhëzimet metodologjike" të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 1955, për herë të parë jepej një përkufizim i familjes, e cila duhej të mbahej parasysh nga nëpunësit e regjistrimit gjatë realizimit të këtij procesi: "Familje, - thuhej në udhëzues, - kemi quajtur një grup personash të bashkuar në lidhje gjaku e gjinie në mes tyre, që në librat e shtëpisë⁴⁶ figurojnë së bashku. Sipas lidhjes së gjakut e të gjinisë që paraqesin pjestarët e familjes në mes tyre bëhet edhe degëzimi i familjes në barqe"⁴⁷.

Për të evidentuar në mënyrë më të saktë migrimin e brendshëm fshat-qytet dhe ligjërimin e tij, Këshilli i Ministrave me urdhëresën nr.17, datë 24 nëntor 1955, duke i bërë disa ndryshime urdhëresës së vitit 1953, nënvizonte se: "Vërtetimin

për shpërngulje duhet ta japë Komiteti Ekzekutiv i Rrethit dhe organet përkatëse të punëve të brendshme, kur i interesuari ka marrë vërtetimin e lëshuar nga vendi pritës për strehim e punë”.

Vlerësuar nga grup pyetjet që pasqyronin, modularët përfundimtare të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të 2 tetorit 1955, përmbanin 2 herë më shumë kërkesa se sa regjistrimi i vitit 1945 apo 1950. Në këto grup pyetje për herë të parë kërkohej përgjigje për përbërjen kombëtare sipas nacionalitetit etnik dhe sipas gjuhës amtare.

Grup- pyetjet e pasqyruara në modulare ishin:

- * Gjeneralitetet e personit
- * Përbërja sociale; sa punojnë; sa janë persona të mbajtur, 48
- * Moshë
- * Përbërja profesionale, profesionet sipas degëve e sektorëve ekonomike,
- * Kuadrot e lartë,
- * Përbërja familjare
- * Shkollimi,
- * Analfabetizmi,
- * Përbërja kombëtare, gjuhët e folura,
- * Migrimet e brendshme fshat-qytet,
- * Gjendja civile,
- * Numri i gjallë i fëmijëve për nënat,

Në të gjithë këto grup pyetje në 31 pyetje do të jepej përgjigje në modularin individual.

3.b. Dokumentet e regjistrimit

Modularët e përdorur gjatë regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë më 2 tetor 1955 ishin:

Mod. "A" - Fletë individuale me kërkesa për gjeneralitet, nivelin arsimor, gjendjen sociale, profesionale, të punësimit dhe kombësisë.

Mod. "B" - Fletë familjare me të dhëna për kryefamiljarin, përbërjen e familjes dhe lidhjet e pjestarëve të familjes me kryefamiljarin.

Mod. "C" - Proçesverbali i nëpunësit të regjistrimit për realizimin e këtij proçesi.

Mod. "D" - Fletë përmbledhëse me të dhënat e rezultuara nga regjistrimi në rang sektori, zone e rrethi.

Mod. "N" - Fletë përmbledhëse e verifikimit të numrit të ndërtesave, inventarizimin e tyre sipas numrit progresiv.

Mod. "S" - Lista e sektorëve në të cilët ishte ndarë njësia përkatëse administrative për efekt të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë.

Përpunimi i materialit të rilevuar nga regjistrimi i popullsisë zgjati gjatë të gjithë vitit 1956. Për përballimin e shpenzimeve të përpunimit të materialit Këshilli i Ministrave me vendimin nr.73 datë 07.03.1956 caktoi fondin prej 3 milionë lekësh.

3.c. Rezultatet më të përgjithshme të regjistrimit

Rezultatet përfundimtare evidencuan një popullsi tërësore të Republikës prej 1391499 banorësh,⁴⁹ prej të cilëve 713316 vetë ishin të gjinisë mashkullore dhe 678183 vetë ishin të gjinisë femërore duke patur një raport 100 femra për 105 meshkuj. Ky numër i përgjithshëm i popullsisë ishte 14% më i madh se ai i rëlevuar nga regjistrimi i vitit 1950. Kjo rritje pasqyron shtesën tërësore të rezultuar nga riprodhimi natyror i popullsisë, pasi migrimi i jashtëm shtetërisht ishte i ndaluar.

Sipas vendbanimit qytet-fshat nga regjistrimi rezultoi se në qytete banonte një popullsi prej 383169 banoresh (ose 27.5%) dhe në fshatra banonte një popullsi prej 1008330 banorësh (ose 72.5%). Kundrejt regjistrimit të vitit 1950 popullsia e qyteteve ishte rritur me 53.4% ose me ritëm mesatar vjetor 1.085, kur popullsia fshatare ishte rritur vetëm me 4% ose me ritëm mesatar vjetor prej 1.0076. Kjo dukuri ka ndodhur për dy arsye:

- * Migrimi më intensiv fshat-qytet;
- * Rritja e numrit të qyteteve nga 24 në 37 qytete.

Grupimi i vendbanimeve sipas numrit të popullsisë po ashtu ka ndryshime kundrejt vitit 1950. Me popullsi gjer në 500 banorë kishte gjithsej 2014 vendbanime ose 75.2% të numrit të përgjithshëm të vendbanimeve, në të cilët ishte e vendosur 37.3% e numrit të përgjithshëm të popullsisë. Kundrejt vitit 1950 si numri i vendbanimeve, edhe numri i popullsisë për kategorinë e vendbanimeve me gjer në 500 banorë, ka pësuar rënie.

Me popullsi 500-1000 banorë kishte 542 vendbanime me 26.6% të popullsisë së përgjithshme. Rilevimi i regjistrimit të vitit 1955 tregoi se ishte rritur ndjeshëm numri i vendbanimeve me 3000-5000 banorë dhe ai 25000-50000 banorë, ç'ka përfaqëson qytetet ku u përqëndrua ndërtimi i objekteve ekonomike e njëherësh edhe migrimi fshat-qytet. Qyteti Tiranë në këtë regjistrim rezultoi me popullsi 108183 banorë, ndërsa qytetet Durrës, Korçë, Shkodër, Vlorë rezultuan me popullsi 25000-38500 banorë.

Struktura grupmoshore e popullsisë sipas regjistrimit të 2 tetorit 1955 ishte:

- * deri në 15 vjeç kishte 540661 banorë (ose 38.8%)
- * 15-60 vjeç kishte 727205 banorë (ose 52.3%)
- * mbi 60 vjeç kishte 123633 banorë (ose 8.9%)

Kundrejt vitit 1950 është rritur pak pesha e grupmoshës gjer në 15 vjeç dhe 15-60 vjeç dhe ka rënë pesha e grupmoshës mbi 60 vjeç. Moshë mediane në regjistrimin e vitit 1955 rezultoi 19.6 vjeç, duke u ulur me 0.4 vjeç ndaj regjistrimit të vitit 1950. Kjo ka qenë rrjedhojë e riprodhimit tepër të zgjeruar natyror të popullsisë dhe rritjes së peshës së grupmoshave shumë të reja.

Lidhur me përkatësinë e nacionalitetit etnik regjistrimi evidentoi se 96.6% e popullsisë⁵⁰ ishte me kombësi shqiptare dhe 3.4% (ose 47227 banorë) e popullsisë me kombësi jo shqiptare.

Popullsia me kombësi jo shqiptare më 1955, kundrejt vitit 1950 është rritur me 34.2% ose me ritëm mesatar vjetor prej 1.058.

Numri i familjeve, sipas të dhënave të regjistrimit ishte 251756 me mesatarisht 5.5 persona. Nga numri i përgjithshëm i familjeve 24.5% kishin gjer në 3 pjesëtarë,

41% kishin 4-6 pjesëtarë, 25.7% e familjeve kishin 7-10 pjesëtarë dhe 8.8% e familjeve kishin 11 gjer mbi 16 pjesëtarë. Sipas ndarjes qytet-fshat numri i familjeve rezultoi: në qytete 78681 familje me mesatarisht 4.9 persona secila dhe në fshat 173075 familje me mesatarisht 5.8 persona.

Gjendja e shkollimit dhe e analfabetizmit rezultoi e tillë: në popullsinë tërësore mbi moshën 8 vjeç, 28,3% ishte analfabet. Sipas gjinisë ky tregues ishte 20% për meshkujt dhe 36% për femrat. Në dy grupmoshat e mëdha, 8-18 vjeç dhe mbi 18 vjeç, treguesi i analfabetizmit ishte:

- * Moshë 8-18 vjeç:
 - Meshkuj-femra: 3.9%
 - Meshkuj: 2.8%
 - Femra: 5.0%
- * Moshë mbi 18 vjeç:
 - Meshkuj-femra: 38.6%
 - Meshkuj: 27.5%
 - Femra: 49.7%

3.1 Regjistrimi i banesave 1957

Si në regjistrimet e realizuara midis dy luftërave botërore, dhe në regjistrimet e viteve 1945, 1950, 1955 në lidhje me banesat ishte realizuar vetëm një inventarizim numerik dhe pjesërisht gjendja e tyre e përgjithshme (e pabanuar ose e banuar).

Nisur nga kjo situatë në vitin 1957 u shtrua problemi i një regjistrimi të plotë të banesave. Për këtë, Këshilli i Ministrave më datën 27.03.1957 mori vendimin nr.75: "Për kryerjen e regjistrimit të banesave"

Regjistrimi zgjati disa ditë. Gjatë regjistrimit u përdorën disa modulare, si:

Mod.A- Me të dhëna për çdo banesë: numri rendor, pronari, mënyra e përdorimit, numri i dhomave, familjet që banojnë në to, numri i frymëve që jetojnë në çdo banesë.

Mod.PM- Përfaqësonte një regjistër përmbledhës ku evidencohej për çdo banesë: sipërfaqja e banimit, lloji i ndërtimit të banesës (me tullë, me gurë, me qerpiç etj.).

Mod.Nu- Regjistër numerik i ndërtesave të banimit të zonës përkatëse.

Mod.Pz- Proçesverbal i inspektimit të zonës, pasi mbaronte proçesi i regjistrimit.

4. Regjistrimi i popullsisë 1960

Si për të gjithë regjistrimet e mëparshme të popullsisë, nevojën e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë në vitin 1960 e shtroi fillimisht Drejtoria e Statistikës në Komisionin e Planit të Shtetit në mbledhjen e Kolegjiut të këtij dikasteri, i cili aprovoi materialin e paraqitur së bashku me tipin e modularëve të mundshëm. Komisioni i Planit të Shtetit më datën 19.04.1960 me shkresë numër 15/1216 ia dërgon projekt-vendimin "Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë" Këshillit të Ministrave.

Në projekt-vendimin e Komisionit të Planit të Shtetit përfshihej: relator për nevojën e kryerjes së regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, modularët përkatës me pyetjet që do të merrnin përgjigje, datën e mundshme të realizimit të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë (në tetor 1960).

Sipas relacionit të projekt-vendimit, nevoja e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë shtrohej për këto arsye:

- * Ndryshimet e mëdha demografike
- * Ndryshimet social-ekonomike
- * Regjistrimet e mëparshme janë bërë sipas metodikës sovjetike e të vendeve të tjera lindore.⁵¹

Relacioni theksonte se në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë do të merren përgjigje për 30 pyetje dhe se me organizimin e punës do të merrej Komisioni Qëndror i Regjistrimit, i cili do të ngrihej pranë Drejtorisë së Statistikës në Komisionin e Planit të Shtetit. Komisioni Qëndror i Regjistrimit do të drejtohej nga Drejtori i Drejtorisë së Statistikës, pranë Komisionit të Planit të Shtetit dhe anëtare të tij do të ishin:

Zv/Ministri i Punëve të Brendshme,
Zv/Ministri i Mbrojtjes
Zv/Ministri i Arsimit Kulturës
Drejtori i Drejtorisë së Ekonomisë Komunale

Në njësitë administrative lokale⁵² do të ngriheshin komisionet përkatëse të kryesuar respektivisht nga Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit, Kryetari i Lokalitetit apo i fshatit e qytetit.⁵³

Për kryerjen e regjistrimit të popullsisë Komisioni i Planit të Shtetit parashikoi një shpenzim prej 8 milionë lekësh.⁵⁴

Këshilli i Ministrave në mbledhjen e tij të datës 01.06.1960, mori në shqyrtim projekt vendimin e propozuar nga Komisioni i Planit të Shtetit e aprovoi atë dhe nxori vendimin nr.255 datë 01.06.1960 "Mbi regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë". Në mbledhje u pranua që regjistrimi të kryhej në muajin tetor 1960 pa caktuar datë fikse. Preventimin e shpenzimeve, të parashikuar në projektvendim nga Komisioni i Planit të Shtetit, Këshilli i Ministrave e zbriti në 6.4 milionë lekë.

Mbështetur në vendimin nr.255, datë 01.06.1960 të Këshillit të Ministrave, me datën 30 Qershor ora 11⁰⁰ mbledhet në Drejtorinë e Statistikës në Komisionin e Planit të Shtetit Komisioni Qëndror i Regjistrimit, i cili përcaktoi masat paraprake për këtë proces. Komisioni Qëndror i Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë me shkresë nr.23/1 datë 04.07.1960 lëshoi qarkoren drejtuar kryesive të komiteteve ekzekutive të rretheve, nëpërmjet të së cilës kërkohej:

- * Krijimin e Komisionit të Rrethit për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë gjer më datën 10.07.1960.
- * Krijimin e Komisionit të Lokalitetit për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë gjer më datën 15.07.1960.
- * Krijimin e Komisionit të fshatit, qytetit e të lagjeve të qytetit për regjistrimin e popullsisë gjer më datën 20.07.1960.

Në qarkoren e lëshuar nga Komisioni Qëndror i Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë specifikohet edhe përbërja e Komisionit të Rrethit për regjistrimin e

përgjithshëm të popullsisë:

Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit	Kryetar
Shefi i seksionit të planit	N/Kryetar
Kryetari i zyrës së regjistrimit. ⁵⁵	Sekretar
Shefi i seksionit të arsim - kulturës.	Anëtar
Shefi i seksionit të ekonomisë	"
Kryetari i degës së Punëve të Brendshme të Rrethit	"
Shefi i Degës Ushtarake të Rrethit	"
Kryetari i Gjykatës së Rrethit	"
Prokurori i rrethit	"
Ekonomisti i zyrës së statistikës	"
Një i deleguar i organizatës së masave	"

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 383, datë 24 gusht 1960 saktëson datën fikse të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë më 2 tetor 1960, ditën e dielë. Sipas këtij vendimi regjistrimi do të bëhej brenda një dite, me ndalim qarkullimi.

Po ashtu u hoq nga Mod. "B" kërkesa me të dhëna për banesën, të cilat do të përmbledheshin në modularë të veçantë : Mod. nr. Nq - për qendrat qytetare dhe Mod. nr. Nf - për qendrat fshatare.

Dokumentacioni përfundimtar i regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë përbëhej nga 3 broshura me udhëzime metodologjike, 6 modularë për popullsinë dhe 2 modularë për regjistrimin e banesave. Në modularët për popullsinë do t'u jepej përgjigje 30 pyetjeve.

4.a. Udhëzuesit metodologjikë

Udhëzuesit metodologjike përbëheshin nga tre broshura, të cilat iu shpërndanë të gjithë atyre që do të aktivizoheshin në procesin e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë apo në plotësimin e formularëve të banesave.

Udhëzuesi 1. Ky udhëzues, si objekt të vetin kishte dhënien e udhëzimeve për ndarjen territoriale të Republikës në sektorë e zona regjistrimi. Në këtë udhëzues ishte përfshirë :

Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë", qarkoria për formimin e komisioneve të regjistrimit të popullsisë së rretheve, lokaliteteve, fshatrave, qyteteve e lagjeve të qyteteve; udhëzime për punën që duhej bërë për emërtimin e rrugëve, numërimin e banesave dhe kontrollin e tyre; udhëzime sesi duhej të veprohej për ndarjen në zona e sektorë si dhe udhëzime për mënyrën e plotësimit të formularit Mod.5, i cili ishte formular përmbledhës.

Udhëzuesi 2. Ky udhëzues, si objekt kishte detyrat e nëpunësit të regjistrimit. Ai përmbante : detyrat paraprake dhe ato gjatë procesit të regjistrimit të popullsisë; shpjegimin e disa koncepteve si popullsi banuese e përhershme, popullsi banuese e përkohshme, koncepti familje, si dhe mënyrën e mbushjes së formularit. Në udhëzuesin nr 2 jepej edhe koncepti "familje", disi më i ndryshëm nga ai i dhënë në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë në vitin 1955, që duhej patur parasysh gjatë procesit të punës.

"Familje quhet një grup personash i bashkuar me lidhje martesë e gjinie

midis tyre dhe që jetojnë ekonomikisht së bashku. Në përgjithësi këta figurojnë të regjistruar së bashku në librat e pasaportizimit”⁵⁶.

Udhëzuesi 3. Ky udhëzues si objekt të vetin kishte detyrat e komisioneve dhe të inspektorëve të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë. Ai përmbante : Njoftime të përgjithshme për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë (qëllimin, objektin, vendin, kohën e regjistrimit); detyrat e Komisionit Qendror, detyrat e inspektorit, detyrat e komisioneve lokale si dhe mënyrën e plotësimit të modularëve.

Në lidhje me ndarjen e popullsisë sipas vendbanimit qytet - fshat, u sugjerua të mbahej parasysh ligji për organizimin administrativ, si dhe dekreti nr. 1882, datë 21.06.1954 “ Për ngritjen e fshatrave në rang qyteti” sipas të cilit “... Ky proces bëhet me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor mbi bazën e propozimit të qeverisë”⁵⁷.

4.b. Dokumentet e regjistrimit të 2 tetorit 1960

Dokumentet e regjistrimit të 2 tetorit 1960 përbëheshin nga dy grupe :

- * Modularët për regjistrimin e banesave.
- * Modularët për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë.

4.b.1. Modularët për regjistrimin e banesave

Ky grup dokumentesh përbëhej nga dy modularë, të cilët duhej të plotësoheshin gjer më datën 5 gusht 1960.

Modularët ishin dy llojesh : Mod.nr.Nf dhe Mod.nr.Nq. Modulari nr Nq, ishte i destinuar për regjistrimin e godinave të banimit në qendrat qytetare. Në këto modularë duhej të pasqyroheshin : numri i ndërtesës, shkallës, apartamentit, llojin e ndërtesës, përdorimin e saj, emrin - mbiemrin e kryefamiljarit të familjes që banonte në të ose të familjeve kur në një ndërtesë banonte më shumë se një familje, numrin e dhomave të ndërtesës apo të apartamentit, numri i familjeve në to, numri i frymëve.

Modulari nr Nf, ishte i destinuar për regjistrimin e godinave të banimit në fshat.

4.b.2. Modularët për regjistrimin e popullsisë.

Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë më 2 tetor 1960 u përdorën 6 modularë, në të cilët do të jepej përgjigje 30 pyetjeve.

Mod. “A” - “Fletë individuale” në të cilën do t’u jepej përgjigje 30 pyetjeve. Në faqen e parë të “Fletë - individuale” kishte kërkesa për : Rrethi ..., Qyteti ose Fshati ..., Lagja ..., Rruga ..., Sheshi ..., Nr i shtëpisë ..., Zona nr ...e regjistrimit, Sektori nr ...regjistrimit, numri i listës ...

Faqja tjetër përmbante 30 pyetje, si : gjeneralitetet e individit, gjinia, vendbanimi, numri i fëmijëve të lindur gjallë dhe sa rrojnë, vendlindja, datëlindja, gjendja civile, marrëdhëniet me kryefamiljarin, gjendja arsimore, puna që kryen, profesioni, grupi shoqëror ku bën pjesë, përkatësia kombëtare, gjuha amtare.

Modulari, pasi plotësohej sipas deklarimeve të personit përkatës, firmosej si nga deklaruesi, edhe nga nëpunësi i regjistrimit.

Mod. "B" - "Fletë familje", ku veç të dhënave të faqes së parë të Mod.A, kërkoheshin të dhëna për numrin e pjesëtarëve të familjes që ishin prezent ose në mungesë. Për personin në mungesë shënohej : emër - mbiemër, lidhja me kryefamiljarin, gjinia, vendi ku gjëndet, koha dhe shkaku i mungesës.

Për personat prezent në formular shënohej : emër - mbiemër, lidhja me kryefamiljarin, gjinia. Ky formular plotësohej nga nëpunësi i regjistrimit, sipas deklarimeve të kryefamiljarit. Pas plotësimit kryefamiljari njihej me të dhënat e deklaruara e të shënuara dhe modulari firmosej si nga kryefamiljari edhe nga nëpunësi i regjistrimit.

Mod.C - "Procesverbali" i nëpunësit të regjistrimit dhe "Listë përmbledhëse" e sektorit. Në këtë modular kërkoheshin të shënohej Rrethi..., Lokaliteti..., Qyteti..., Fshati..., Lagja..., Zona nr..., Sektori nr..., Rruga..., Sheshi..., Numri tek prej ...gjer ...i banesave të familjeve, Numri çift prej ...gjer...

Më tej vazhdonte procesverbali, ku shënohej fillimi i punës, materialet e marra në dorëzim, të plotësuar ose jo, në copë. Ky procesverbal firmosej nga nëpunësi i regjistrimit të sektorit dhe vërtetohej nga inspektori i regjistrimit të zonës.

Në faqen tjetër Mod.C përmbante të dhëna përmbledhëse, si : numrin rendor, emri - mbiemri i kryefamiljarit, numrin progresiv të banesës, popullsinë banuese prezente, popullsinë banuese në mungesë, popullsinë e përkohshme dhe popullsinë gjithsej :

Mod. K - Përmbante listën emërore të anëtarëve të komisionit të regjistrimit.

Mod. R. - Përmbante listën emërore të nëpunësve të regjistrimit të sektorit apo të zonës.

Mod.S. - Përmbante listën e sektorëve të regjistrimit me këto kërkesa : Nr ... i sektorit, Fshati..., Fshati i bashkuar..., Lagja e qytetit..., Rruga - sheshi..., numri i ndërtesave që përfshin sektori tek prej gjer ..., numrin e familjeve :..., numrin e frymëve.

4.c Rezultatet më të përgjithshme të regjistrimit

Përpunimi përfundimtar i materialeve të regjistrimit të popullsisë që vazhdoi gjer nga mesi i vitit 1961, evidentoi një popullsi të përgjithshme prej 1626315 banorësh⁵⁸ prej të cilëve 831294 vetë ishin meshkuj dhe 795021 vetë ishin femra.

Ky numër i përgjithshëm i popullsisë ishte 16,8% më i madh, se ai i rilevuar në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë në vitin 1955. Kjo rritje pasqyron tërësisht masën e shtimit të përgjithshëm natyror, duke qenë i njëjtë me të.

Sipas vendbanimit qytet - fshat nga regjistrimi rezultoi se në qendrat qytetare banonte një popullsi prej 502456 vetash (ose 30,9 %), ndërsa në fshat banonte një popullsi prej 1123859 vetash (ose 69,1 %).

Kundrejt regjistrimit të vitit 1955 popullsia në vendbanimet e cilësuar qytet, në vitin 1960, ishte rritur me 31,1 % ose me ritëm mesatar vjetor prej 1,056 çka tregon rënie në krahasim me të mëparshmin. Kjo shpreh atë që migrimi drejt qytetit gradualisht po ulet, megjithëse akoma i jep tonin rritjes së popullsisë banuese

në qytet. Në migrantët urbanë vendin kryesor e ka zënë elementi i ri, veçanërisht i gjinisë mashkullore. Nga të dhënat e regjistrimit të 2 tetorit 1960, del se nga numri i përgjithshëm i qendrave të banimit (2102⁵⁹ prej të cilave 41 qytete dhe 2061 fshatra) 62,8% kishin popullsi mesatare gjer në 500 banorë, duke dhënë 21,9 % të numrit të përgjithshëm të popullsisë, 22,6% e qendrave të banimit kishin 501 - 1000 banorë me popullsi tërësore prej 20,3% ; 13,9 % e vendbanimeve kishin 1001 - 10000 banorë duke dhënë 32,3% të numrit të përgjithshëm të popullsisë. Vetëm 0,7 % ishte numri i vendbanimeve (përfaqësuar tërësisht nga qytetet) që kishin popullsi mbi 10000 banorë, duke zënë 25,5 % të numrit të përgjithshëm të popullsisë së rëlevuar gjatë regjistrimit.

Struktura grupmoshore e popullsisë e rëlevuar nga regjistrimi i 2 tetorit 1960 ishte :

- Për moshën gjer në 15 vjeç 667931 banorë (ose 41,1%)
- 15 - 60 vjeç kishte 826273 banorë (ose 50,7%)
- Për moshën mbi 60 vjeç kishte 132111 banorë (ose 8,2 %)

Kundrejt regjistrimit të vitit 1955 vihet re se ka rritje të ndjeshme pesha e grupmoshës së fëmijëve (0 - 15 vjeç) rezultat ky i riprodhimit të zgjeruar natyror të popullsisë që në këtë interval kohor arriti nivelet më të larta.

Mosha mediane e popullsisë së përgjithshme rezultoi në 18,8 vjeç me një rënie kundrejt vitit 1955 prej 0,8 vjet.

Sipas të dhënave grupmoshore të regjistrimit të popullsisë vihen re diferencime sipas ndarjes qytet - fshat :

* Në qytete :

- Moshë gjer në 15 vjeç kishte 193915 vetë (ose 38,6 %)
- Moshë 15 - 60 vjeç kishte 275205 vetë (ose 54,8 %)
- Moshë mbi 60 vjeç kishte 33336 vetë (ose 6,6 %)

* Në fshat :

- Moshë gjer në 15 vjeç kishte 474016 vetë (ose 42,2 %)
- Moshë 15 - 60 vjeç kishte 551068 vetë (ose 49,0 %)
- Moshë mbi 60 vjeç kishte 98775 vetë (ose 8,8 %)

Krahasimi midis tyre i grup treguesve evidenton ndryshim :

a. Në moshën gjer në 15 vjeç pesha në qytet është më e vogël se në fshat, ku riprodhimi natyror është shumë i zgjeruar.

b. Në moshën 15 - 60 vjeç pesha është më e madhe në qytet, pasojë kjo e migrimit të fuqisë punëtore nga fshati në qytet. Migrimi më së shumti ka përfshirë meshkujt e moshës 20 - 34 vjeç, si mosha më e preferuar e fuqisë punëtore në objektet ekonomike. Këtë evidenton edhe struktura gjinore sipas moshës, ku në moshën 20 - 34 vjeç ndërsa femrat zinin 42,7 % të popullsisë përkatëse, meshkujt zinin 57,3 %. Në fshat vihet re se në moshën 20 - 34 vjeç femrat zinin 49 % dhe meshkujt 51 %. Defiçiti i ndjeshëm meshkujsh në fshat vihej re sidomos në moshën 20 - 24 vjeç, ku femrat zinin 52,2 % të popullsisë së asaj grupmoshe.

Ndryshime vihen re edhe në moshën mediane, ku në qytet ishte 20,3 vjet dhe në fshat 18,1 vjet.

Lidhur me përkatësinë e nacionalitetit etnik regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë më 2 tetor 1960, rilevoi 1581745 banorë shtetas shqiptarë me kombësi shqiptare

dhe 44570 banorë shtetas shqiptarë me kombësi jo shqiptare ⁶⁰.

Numri i familjeve, sipas të dhënave të regjistrimit, rezultoi gjithsej 279805 familje, me mesatarisht 5,8 persona. Në qytet numri i familjeve ishte 95491 me mesatarisht 5,3 persona secila; ndërsa në fshat numri i familjeve ishte 184314 me 6,1 pjesëtarë secila.

Gjithë vendi në 1960 kishte 22,8 % të numrit të familjeve me gjer në 3 pjesëtarë, 41,3 % me 4 - 6 pjesëtarë, 29,1 % me 7 - 10 pjesëtarë dhe 6,8 % të familjeve me mbi 11 pjesëtarë.

Familje me mbi 7 pjesëtarë në qytet kishte vetëm 23,5 % të numrit të përgjithshëm të kësaj kategorie, kur në fshat kishte 76,6 %.

Gjendja e shkollimit dhe e analfabetizmit rezultoi e tillë ku në popullsinë tërësore, për të dy gjinitë, 31,8 % e numrit të popullsisë mbi 10 vjeç ishte analfabet dhe 68,2 % dinte shkrim e këndim. Për femrat analfabetizmi ishte 43,9 % kurse për meshkujt ishte 19,7 %. Popullsia qytetare rezultoi me një analfabetizëm prej 19,5 % (femrat 30,3 %) dhe ajo fshatare me një analfabetizëm 37,5 % (femrat 49,4 %).

5. Regjistrimi i popullsisë 1969

Pas një intervali kohor prej 8 - 9 vjetësh nga regjistrimi i vitit 1960, u shtrua nevoja e realizimit të një regjistrimi të ri të popullsisë në Shqipëri.

Për këtë, në korrik të vitit 1968, Drejtoria e Statistikës në Komisionin e Planit të Shtetit merr në diskutim problemet që e bënin të domosdoshëm kryerjen e një regjistrimi të ri të përgjithshëm të popullsisë. Pasi u diskutua ky problem, ku u shtruan edhe argumentimet përkatëse, Komisioni i Planit i dërgon me shkresë nr.9/429, datë 12.07.1968 propozimin Këshillit të Ministrave "Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë". Propozimi bashkëshoqërohej edhe me modularët e mundshëm që do të përdoreshin në procesin e regjistrimit.

Këshilli i Ministrave, propozimin e Komisionit të Planit të Shtetit "Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë" gjatë vitit 1969, e merr në diskutim me datën 13.09.1968 dhe me datën 18.09.1968 nxori vendimin nr.134 "Mbi regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë" ⁶¹. Ky vendim përmbante :

a. Kohën e kryerjes së regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë (30 mars - 15 prill 1969)

b. Fondin e shpenzimeve për realizimin e regjistrimit (800000 lekë)

c. Miratimin e modularëve të propozuar për t'u përdorur në procesin e regjistrimit.

Sipas vendimit, për herë të parë ndryshonte mënyra e kryerjes së regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, nga një regjistrim me ndalim qarkullimi (në vitet 1945, 1950, 1955, 1960) në një regjistrim të hapur me lejim qarkullimi.

Njëherësh, po sipas vendimit dhe përmbajtjes së modularëve, regjistrimi i vitit 1969 ka qenë më i cinguari, duke patur nivelin më të ulët të kërkesave (vetëm 21), të cilat në pjesën më të madhe kishin të bënin me gjendjen sociale e profesionale të individëve e familjeve.

Po kështu në kërkesat e regjistrimit të vitit 1969 u mënjantuan edhe të dhënat

në lidhje me banesat.

Me daljen e vendimit të Këshillit të Ministrave ngrihet, pranë Drejtorisë së Statistikës në Komisionin e Planit të Shtetit, Komisioni Qendror i regjistrimit të Popullsisë me po atë përbërje si dhe në regjistrimin e vitit 1960. Ngritja e Komisionit Qendror u aprovua nga Këshilli i Ministrave, ndërsa ngritja e komisioneve në rrethe u aprovua nga Komisioni Qendror dhe ngritja e komisioneve në fshatrat e bashkuar, fshatra, qytete e lagje qytetesh u aprovuan nga komisioni i rrethit.

Komisioni Qendror i regjistrimit të popullsisë përgatiti dhe shpërndau "Udhëzuesin metodologjik" dhe programin orientues të detyrave i përbërë nga dy pjesë : para fillimit të procesit të regjistrimit të popullsisë dhe gjatë procesit të regjistrimit.

"Udhëzuesi metodologjik" përmbante po ato elemente si dhe të mëparshmit : probleme të përgjithshme, shpjegimin e përmbajtjes së fletëregjistrimit, mënyrën e plotësimit, mënyrën e organizimit të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, detyrat e nëpunësve të regjistrimit sipas niveleve të ndarjes administrativo - tokësore etj.

5.a. Modularët për regjistrimin e popullsisë në 1969.

Në këtë regjistrim të popullsisë vëmendja më së shumti u tërhoq nga aspekti social - profesional i popullsisë. Kjo ishte një arsye dhe arsyeja tjetër duke mos u njohur me praktikën ndërkombëtare e veçanërisht evropiane, për realizimin e regjistrimeve të përgjithshme sa më të plotë e shkencore, bënë që regjistrimi i vitit 1969 të jetë më i cunuar. Në kërkesat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë për herë të parë nuk pasqyrohen të dhëna të tilla, si: shtetësia, kombësia, gjuha amtare, numri i fëmijëve të lindur gjallë nga femrat nëna, fëmijët që rrojnë etj.

Nga ana tjetër mungesa e një metode të kualifikuar dhe efikase për përpunimin e materialit të rilevuar në kushtet e regjistrimit të hapur, bënë që edhe përpunimi të mos jetë i plotë dhe i saktësuar.

Modularët e përdorur gjatë regjistrimit ishin :

Mod. A "Fletë individuale", e cila në faqen e parë përmbante të dhëna për adresën e individit dhe për sektorin e zonën e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë. Në faqen e dytë ishin shënuar 21 kërkesa për individin, si : emri, atësia, mbiemri, gjinia, gjendja civile, arsimimi, gjendja profesionale, gjendja sociale etj.

Mod.B "Fletë familje", e cila në fillim përmbante të dhënat për adresën e kryefamiljarit si : rrethi, qyteti ose fshati, lagja, rruga, numri i shtëpisë, sektori e zona e regjistrimit. Më tej kërkoheshin të dhëna për kryefamiljarin e pjesëtarët e tjerë të familjes si : emri e mbiemri i kryefamiljarit, dhomat në dispozicion, gjendja e furnizimit elektrik, me ujë, numri i pjesëtarëve të familjes, gjinia e tyre, pjestarët e familjes që nuk janë të pranishëm (emri e mbiemri i tyre, marrëdhënia me kryefamiljarin, gjinia, ku gjendet, shkaku i mungesës.)

Më shumë se në çdo regjistrim tjetër të përgjithshëm të popullsisë, në regjistrimin e vitit 1969 u përdorën pasqyrat, të cilat për nga grupimet që kërkoheshin ato përdoreshin për herë të parë.

Pasqyra nr.1. Në të do të shënoheshin familjet sipas numrit të frymëve dhe sipas tre strukturave të mëdha moshore : nën moshën e punës, në moshën e punës, mbi moshën e punës ⁶².

Pasqyra nr.2. Gruponte familjet sipas strukturës sociale dhe numrit të pjesëtarëve.⁶³

Pasqyra nr.3. Bënte grupimin e familjeve sipas numrit të kurorave dhe të brezave.

Pasqyra nr.4. Përmbante popullsinë sipas moshës e gjendjes civile.

Pasqyra nr.5. Pasqyronte popullsinë sipas nivelit të shkollimit.

Pasqyra nr.6. Pasqyronte popullsinë që punonte e popullsinë që nuk punonte.

Pasqyra nr.7. Bënte grupimin e popullsisë që punonte: sipas profesionit, vjetërsisë në punë, shkallës arsimore, gjinisë e moshës.

Pasqyra nr.8. Gruponte punëtorët sipas kategorisë personale dhe moshës.

5.b. Rezultatet më të përgjithshme të regjistrimit të vitit 1969

Pas përfundimit të përpunimit të të dhënave që u rievuan gjatë regjistrimit ⁶⁴, i cili vazhdoi gjatë gjithë vitit 1969, rezultoi një popullsi e përgjithshme prej 2068155 banorësh ⁶⁵. Nga kjo popullsi 1005224 veta ishin të gjinisë femërore (48,6 %) dhe 1062931 veta (ose 51,4%) ishin të gjinisë mashkullore.

Kundrejt vitit 1960 popullsia e përgjithshme u rrit me 27,1% ose me ritëm mesatar vjetor prej 1.0277. Në numër absolut popullsia u shtua me 441463 persona, aq sa ka dhënë shtesa natyrore e intervalit kohor.

Sipas vendbanimit qytet - fshat nga regjistrimi i vitit 1969 rezultoi që 650710 banorë jetonin në 56 qytete dhe 1417445 banorë jetonin në 2545 fshatra. Llogaritur në përqindje struktura qytet - fshat e popullsisë së rievuar nga regjistrimi ishte respektivisht 31,5% dhe 68,5%.

Krahasuar me vitin 1960 në vitin 1969, popullsia në vendbanimet e cilësuar qytete ishte rritur me 34,3% ose me 166345 persona, prej të cilëve 111918 persona (67,3%) nga shtimi natyror i vetë popullsisë qytetare dhe 54427 persona (32,7%) nga migrimi fshat - qytet.

Të dhënat e regjistrimit të 1 prillit 1969 treguan se fshatrat me popullsi, gjer në 200 banorë, përbënin 13,5% të numrit të qendrave të banuara, me 201 - 500 banorë 43,5% e numrit, 501 - 1000 banorë 31,3%, mbi 1000 banorë 11,7%. Për qytetet vihet re se ata me popullsi gjer në 5000 banorë zinin 58,2% të numrit të qyteteve, 5001 - 20000 banorë 27,3 %, 20001 - 50000 banorë 9,1 % dhe mbi 50000 banorë vetëm 3,6% e numrit të qyteteve. Qyteti i Tiranës në këtë vit kishte 152768 banorë.

Struktura grupmoshore e popullsisë së rievuar nga regjistrimi i 1 prillit 1969 ishte :

- * Për moshën gjer në 15 vjeç 878174 banorë (42,5%)
- * Për moshën 15 - 60 vjeç 1042018 banorë (50,4%)
- * Për moshën mbi 60 vjeç 147963 banorë (7,1%)

Krahasuar me vitin 1960 vihet re se ka vazhduar rritja e grupmoshës së fëmijëve dhe është ulur më tej ajo e moshës së tretë (60 vjeç e lart). Një gjë e tillë

është pasqyrim i drejtpërdrejtë i riprodhimit natyror tepër të zgjeruar, që ka qenë prezent edhe gjatë viteve 60⁶⁶.

Mosha mediane e popullsisë së gjithë vendit më 1 prill 1969 rezultoi 18,9 vjeç, pothuajse në kufijtë e regjistrimit të mëparshëm. Për femrat kjo moshë mediane ishte 19,1 vjeç, ndërsa për meshkujt ishte 18,7 vjeç.

Vlerësuar sipas vendbanimit qytet - fshat grupmoshat e rëluara nga regjistrimi kishin një strukturë të tillë :

* Në qytet

- Mosha gjer në 15 vjeç kishte 254139 banorë (39,0%)
- Mosha 15 - 60 vjeç kishte 353523 banorë (54,4%)
- Mosha mbi 60 vjeç kishte 43048 banorë (6,6%)

* Në fshat

- Mosha gjer në 15 vjeç kishte 624035 banorë (44,0%)
- Mosha 15 - 60 vjeç kishte 688495 banorë (48,6%)
- Mosha mbi 60 vjeç kishte 104915 banorë (7,4%)

Midis tipeve të vendbanimeve ka patur diferencime të dukshme në strukturën grupmoshore. Në qytete rezultoi e lartë grupmosha e punës, çka ishte rrjedhojë e ndikimit të ndjeshëm të migrimit, të fuqisë punëtore në radhë të parë, nga fshati drejt qytetit. Ky proces duke mos u bashkëpërcjellë me sigurimin e fronteve të punës në qytet solli atë që nga regjistrimi të rëlvohet një papunësi në qytete prej 38500 vetë ose 11,2% e rezervave të punës në vendbanimet qytetare.

Nga të papunët në qytet 33% e zinin personat 15 - 29 vjeç, 22% personat 30 - 39 vjeç, 45% personat 40 vjeç e lart.

Në fshat, sipas regjistrimit, rezultoi e lartë mosha e fëmijërisë. Kjo ishte rrjedhojë më së shumti e riprodhimit më të zgjeruar natyror të popullsisë⁶⁷.

Mosha mediane sipas vendbanimit qytet - fshat, mbështetur në të dhënat grupmoshore 5 vjeçare të regjistrimit, ishte :

- * Për gjithë popullsinë në qytet 19,6 vjeç.
- * Për popullsinë mashkullore në qytet 19,3 vjeç.
- * Për popullsinë femërore në qytet 19,8 vjeç.

Diferencimi gjinor, krahas ligjësisë së përgjithshme është kushtëzuar edhe nga migrimi fshat - qytet më së shumti i fuqisë së re mashkullore.

- * Për gjithë popullsinë në fshat 18,2 vjeç.
- * Për popullsinë mashkullore në fshat 18,0 vjeç.
- * Për popullsinë femërore në fshat 18,3 vjeç.

Kushtëzues kryesor në këtë tregues ka qenë niveli shumë i lartë i riprodhimit natyror. Lidhur me përkatësinë e nacionalitetit etnik, regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i 1 prillit 1969 nuk rëlvoi asnjë të dhënë, pasi një kërkesë e tillë ishte eliminuar nga fleta - individuale.

Numri i përgjithshëm i familjeve të rëlvuara nga regjistrimi ishte 346588⁶⁸ me mesatarisht 5,9 persona për familje. Nga ky numër familjesh 19,8% kishin

gjer në 3 pjestarë mesatarisht, 43,1% familje kishin 4 - 6 pjestarë mesatarisht, 31,1% kishin 7 - 10 pjestarë dhe 6% e familjeve kishin mbi 10 persona. Vështuar sipas vendbanimit qytet - fshat del se në qytet kishte gjithsej 126618 familje me mesatarisht 5 persona çdo familje, ndërsa në fshat kishte gjithsej 219970 familje me mesatarisht 6,1 persona çdo familje.

Nga vlerësimi krahasues i pjestarëve për familje prej vitit 1923 e gjer në vitin 1969 vihet re se për të gjithë popullsinë mesatarja është luhatur në kufijtë respektive, 5,6 - 5,9 persona. Për vendbanimet qytetare ky tregues është luhatur :

- * për vitet 1923 - 1950 nga 4,9 - 4,7 persona;

- * për vitet 1955 - 1969 nga 4,9 - 5 persona.

Për vendbanimet fshatare ky tregues ka qenë pothuajse gjithmonë në nivelin e 6,1 personave.

Rritja e numrit të pjestarëve për qytetin pas vitit 1950 është e lidhur me migrimin rural dhe bashkëshoqërimin e tij me tiparet rurale të riprodhimit të popullsisë. Këtë vë në dukje edhe rritja e numrit të familjeve me shumë pjestarë. Pas vitit 1950 është rritur për gjithë vendin 44,7% numri i familjeve me 4 - 6 anëtare, 66,6% numri i familjeve me 7 - 10 anëtare dhe 9,4% numri i familjeve me më shumë se 11 anëtare. Po në këtë interval kohor në qytet numri i familjeve me 7 - 10 anëtarë është rritur me 30%, dhe ai me 11 anëtarë e lart 15,4%, kur numri i familjeve qytetare me 4 - 6 anëtarë është rritur me 43,5%.

Gjendja e shkollimit dhe e analfabetizmit rezultoi :

- * për gjithë popullsinë niveli i alfabetizmit në moshën mbi 10 vjeç ishte 21,9%, kur për femrat ishte 30% dhe meshkujt 13,9%.

- * për popullsinë qytetare ky tregues ishte 14% kur për femrat ishte 21% dhe meshkujt 7%.

- * për popullsinë fshatare analfabetizmi ishte për gjithë popullsinë 25,2%, për femrat ishte 34,3% dhe meshkujt 16,7%.

Sipas grupmoshave niveli i alfabetizmit ishte :

- * për moshën 10 - 39 vjeç 5,6%.

- * për moshën 40 - 49 vjeç 36,6%.

- * për moshën mbi 50 vjeç 73,8%.

6. Regjistrimi i popullsisë 1979

Duke vërejtur veçoritë e evolucionit demografik të vendit, Drejtoria e Statistikës në Komisionin e Planit të Shtetit, ngriti nevojën e organizimit të një regjistrimi të ri të përgjithshëm të popullsisë. Për këtë ajo hartoi një informacion të cilin ja paraqet Kolegjiumit të Komisionit të Planit të Shtetit. Kjo instancë e merr në diskutim problemin e shtruar nga Drejtoria e Statistikës më 10.12.1976, pranon nevojën e regjistrimit dhe sugjeroi që regjistrimi të bëhej në muajt shtator - tetor 1978.

Gjatë vitit 1977 Drejtoria e Statistikës, në Komisionin e Planit të Shtetit, hartoi relacionin si dhe modularët e pasqyrat e mundshme për tu përdorur gjatë regjistrimit të ardhshëm të popullsisë. Materiali i kompletuar kaloi përsëri në diskutim në mbledhjen e kolegjiut të Komisionit të Planit ku u aprovua dhe me shkresë të veçantë ju dërgua Këshillit të Ministrave, në formën e një projekt - vendimi, për të

marrë vendimin përkatës.

Këshilli i Ministrave e diskuton problemin e propozuar për regjistrimin e ri të përgjithshëm të popullsisë në janar të vitit 1978 dhe më 27.01.1978 mori vendimin nr.17 "Mbi regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë", i cili do të përfshinte edhe regjistrimin e banesave ⁶⁹.

Vendimi i Këshillit të Ministrave përmbante :

- * Qëllimin e kryerjes së regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë.
- * Kohën e kryerjes së regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë (7 - 16 janar 1979) ⁷⁰.
- * Organizmat shtetëror që do të drejtonin punën për realizimin e regjistrimit të popullsisë (Drejtoria e Statistikës në Komisionin e Planit të Shtetit dhe Komitetet Ekzekutive të këshillave popullore në rrethe).
- * Fondin e shpenzimeve për realizimin e regjistrimit dhe rrugët e sigurimit të tij.
- * Aprovimin e modularëve dhe pasqyrave të nevojshme dhe dikasterin që do të interesohej për shtypjen e shumëfishimin e tyre.
- * Aprovimin e programit të punës dhe të përbërjes së Komisionit Qendror të regjistrimit.

Me daljen e vendimit të Këshillit të Ministrave filloi nga puna Komisioni Qendror i Regjistrimit i cili përgatiti udhëzuesit metodologjike dhe lëshoi urdhëresën për formimin e komisioneve të regjistrimit në rrethe, të cilat aprovoreshin nga Komisioni Qendror dhe në fshatra të bashkuara, fshatra, qytete e lagje qytetesh, të cilët aprovoreshin nga komisionet e rretheve.

Koha e lënë në dispozicion nga vendimi nr.17, për realizimin e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë tregon se mënyra e realizimit të procesit ka qenë e hapur pa ndalim lëvizjeje.

6.a. Dokumentet e regjistrimit të vitit 1979

Dokumentet e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të 7 janarit 1979, përbëheshin nga 3 grupe :

- * Udhëzuesit metodologjike.
- * Modularët për deklaram të dhënash.
- * Pasqyrat përmbledhëse për popullsinë dhe banesat.

Në udhëzuesin për nënpunësin e regjistrimit u specifikuan edhe sqarimet në lidhje me përcaktimin e grupit shoqëror të individit. Për këtë u urdhëruan të gjithë dikasteret që ndërmarrjet apo institucionet në varësi të tyre tu lëshonin punonjësve shënimet e nevojshme zyrtare ⁷¹.

6.a.1. Modularët për deklaram të dhënash

Në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë më 7 janar 1979 u përdorën gjithsej tri modularë, ku numri i pyetjeve që kërkonin përgjigje ishte 17, duke u zvogëluar edhe më ndaj vitit 1969. Modularët e përdorur në regjistrim ishin :

Mod.A. "Fletë individuale" në të cilën do të pasqyroheshin të dhëna për 17

tregues. Në këtë modular në krahasim me vitin 1969 u pakësuan disa tregues, por u pasqyrua e dhëna për kombësinë, numrin e fëmijve të lindur gjallë nga gratë nëna dhe sa prej tyre jetonin.

Faqja e parë e Mod.A përmbledhë të dhëna për adresën e individit sipas hierarkisë administrative : rrethi, fshati i bashkuar - fshati - qyteti - lagja, rruga, numri i banesës etj.

Faqja e dytë përmbante pyetje për individin si : emri, atësia, mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, gjendja civile, gjendja arsimore, specialiteti, koha e marrëdhënies në punë, gjendja shoqërore, kombësia, numri i fëmijve të lindur gjallë nga gratë nëna, numri i fëmijve që rrojnë.

Për personat që në momentin e regjistrimit nuk ishin në familje u plotësuan dy modularë "A" : njëra në familjen e tij, në vendbanimin e përhershëm dhe tjetra në vendin ku e gjeti regjistrimi. Modulari në familje u plotësua sipas deklarimeve të pjestarëve të familjes, ndërsa në vendndodhje nga vetë personi. Modulari i plotësuar në vendndodhje u dërgua, gjatë përpunimit, në vendbanimin e tij të përhershëm, pasi u vlerësua në përlllogaritjen e vendndodhjes si banor i përkohshëm.

Mod.B. "Fletë - familje" në të cilën do të pasqyroheshin të dhëna për vendndodhjen e familjes, kryefamiljari, gjendja shoqërore e tij, të dhëna për numrin e pjestarëve të familjes, gjininë e tyre, moshën, gjendjen e punësimit. Të specifikuar shënoheshin pjestarët e familjes që nuk ishin prezent dhe marrëdhënia me kryefamiljarin, vendin ku ndodhej personi që mungonte në familje, arsyen se pse mungonte.

Mod.C. "Fletë regjistrimi" me kërkesa për banesën e familjes. Në këtë modular do të jepeshin të dhëna për vendndodhjen (adresën) e banesës, pronësinë, mënyrën e furnizimit me ujë, gjendja me WC, viti i ndërtimit, dhomat e banesës, sipërfaqen e banimit, personat që banojnë në të.

6.a.2 Pasqyrat përmbledhëse për popullsinë dhe banesat

Më shumë se në çdo regjistrim tjetër, në atë të janarit 1979, u përdor një seri pasqyrash, që mund të përbëjnë dy grupe :

- * Pasqyrat për banesat
- * Pasqyrat për popullsinë

1. Pasqyrat për banesat përbëheshin nga 5 copë, të cilët do të paraqisnin të dhëna të grupuara të banesave sipas numrit të dhomave, të personave dhe sipas grupit shoqëror të kryefamiljarit; grupim sipas numrit të dhomave e të barqeve, grupim sipas sipërfaqes së banimit e numrit të banorëve; gjëndjes me ujë e WC etj.

2. Pasqyrat për popullsinë përbëheshin nga 16 copë ku do të hidheshin të dhënat e Mod.A dhe Mod.B.

Disa nga pasqyrat ishin :

* Ato që përfshinin numrin e familjeve sipas numrit të pjestarëve, sipas gjëndjes në moshë pune e të punësimit, sipas grupit shoqëror të kryefamiljarit, të numrit të barqeve etj.

* Pasqyrat që përmbanin popullsinë sipas moshës e gjinisë, sipas grupmoshave

e gjendjes civile.

- * Pasqyrat që përmbanin popullsinë sipas aftësisë për shkrim e këndim, shkallës së arsimit. Këta tregues shpreheshin të gërshetuar me grupin shoqëror e grupimet moshore.

- * Pasqyrat që përmbanin të dhëna të grupuara për popullsinë sipas gjinisë, grupit shoqëror, degëve të ekonomisë, grupprofesioneve, grupprofesioneve e shkallës arsimore.

- * Pasqyra për popullsinë që nuk punonte grupuar sipas grupmoshave dhe grupit shoqëror.

- * Pasqyra që përmbante të dhëna për numrin e grave të grupuara sipas grupmoshës dhe fëmijve të lindur gjallë; sipas grupmoshës dhe fëmijve që jetonin.

- * Pasqyra e ndarjes së territorit të dhënë në sektorë e zona regjistrimi.

6.b.Rezultatet më të përgjithshme të regjistrimit 1979 ⁷²

Pas përfundimit të përpunimit të të dhënave të rilevuara nga regjistrimi i popullsisë i 7 janarit 1979, i cili vazhdoi më se një vit, rezultoi një popullsi e përgjithshme prej 2590260 banorë ⁷³. Sipas të dhënave të "Vjetari Statistikor i Shqipërisë" 1991, numri i përgjithshëm i popullsisë ka rezultuar me 2590600 ⁷⁴ banorë.

Diferenca me të dhënë e librave është vetëm 340 banorë ose 0.013% duke mos përbërë ndonjë problem.

Nga kjo popullsi 1253315 banorë rezultuan të gjinisë femërore dhe 1336945 banorë të gjinisë mashkullore. Raporti gjinor rezultoi 48,4% femra dhe 51,6% meshkuj.

Kundrejt vitit 1969 numri i përgjithshëm i banorëve të vendit pati një rritje prej 25,3%, rritje që i përgjigjej shtimit tërësor natyror.

Vlerësuar sipas vendbanimit qytet - fshat të dhënat e regjistrimit paraqiten 866704(33,5%) banorë urbane dhe 1723556 banorë ruralë(66,5%).

Pesha e gjinive në popullsinë urbane ishte 49% femra dhe 51% meshkuj, ndërsa në popullsinë rurale ishte 48% femra dhe 52% meshkuj. Kjo dukuri ka qenë kushtëzuar me migrimin më të ndjeshëm të elementit femër drejt qytetit nëpërmjet martesave.

Kundrejt vitit 1969 popullsia urbane u rrit me 33,2% ose me 215994 banorë dhe popullsia rurale u rrit 21,6%. Në rritjen e popullsisë urbane 60,9% e ka siguruar shtimi natyror i asaj popullsie dhe 39,1% migrimi fshat - qytet. Në rritjen e popullsisë rurale shtimi natyror i saj është pasqyruar vetëm me 78,4%, duke u karakterizuar kjo popullsi nga saldo migruese negative në masën e 21,6% të vlerës së shtimit natyror.

Numri i vendbanimeve qytetare në regjistrim ishte 65 dhe i atyre fshatare ishte 2641.

Sipas numrit të banorëve kategorizimi i vendbanimeve ishte:

-Vendbanimet fshatare

* gjer në 200 banorë 322 fshatra

- * 201 - 500 banorë 998 fshatra
- * 501 - 1000 banorë 866 fshatra
- * 1001 - 2000 banorë 401 fshatra
- * 2001 - 3000 banorë 42 fshatra
- * mbi 3000 banorë 12 fshatra

* Vendbanimet qytetare

- * gjer në 5000 banorë 32 qytete
- * 5001 - 20000 banorë 23 qytete
- * 20001 - 50000 banorë 4 qytete
- * mbi 50000 banorë 6 qytete

Qyteti i Tiranës sipas regjistrimit të vitit 1979 kishte 189000 banorë. Ndërsa qytetet Korçë, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Durrës kishin nga 52800 - 66200 banorë.

Struktura moshore e rilevuar nga regjistrimi ishte:

- * Për moshën gjer në 15 vjeç 958199 banorë (37,1%).
- * Për moshën 15 - 60 vjeç 1439300 banorë (55,6%).
- * Për moshën mbi 60 vjeç 192761 banorë (7,5%).

Krahasuar me vitin 1969 vihet re se grupmosha e re ka patur rënie dhe është rritur grupmosha e punës. Kjo ka ndodhur për arsye se intensiteti i riprodhimit natyror ka patur ulje dhe nga ana tjetër rënia e grupmoshave të reja në atë të punës ka qenë në përpjestime më të konsiderueshme se sa zëvendësimi me riprodhimin natyror, veçanërisht në qytete.

Mosha mediane e popullsisë së gjithë vendit më 7 janar 1979 rezultoi 19.5 vjeç duke qenë më e lartë se në prill 1969. Për femrat mosha mediane ishte 19.8 vjeç dhe për meshkuj 19.2 vjeç.⁷⁵

Vlerësuar sipas vendbanimit qytet-fshat grupmoshat e rilevuara nga regjistrimi kishin një strukturë të tillë:

Në qytet

Mosha gjer në 15 vjeç 273508 banorë (31.5%)
 Mosha 15-60 vjeç 532348 banorë (61.4%)
 Mosha mbi 60 vjeç 60848 banorë (7.1%)

Në fshat

Mosha gjer në 15 vjeç 684691 banorë (39.7%)
 Mosha 15-60 vjeç 906952 banorë (52.6%)
 Mosha mbi 60 vjeç 131913 banorë (7.7%)

Mosha mediane për popullsinë e të dy gjinive në qytet ishte 22.5 vjeç, kur për femrat ishte 22.7 vjeç dhe për meshkujt 22.3 vjeç.

Në fshat mosha mediane për të dy gjinitë ishte 18.3 vjeç, kur për femrat ishte 18.2 vjeç dhe për meshkujt ishte 18.4 vjeç. Këto ndryshime kanë të bëjnë me veçoritë e migrimit të popullsisë në drejtimin fshat-qytet dhe të intensitetit të ndryshëm të riprodhimit natyror të popullsisë në qytet e në fshat.

Lidhur me përkatësinë e nacionalitetit etnik, regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë më 7 janar 1979 rilevoi 2535573 banorë shtetas shqiptarë të nacionalitetit etnik shqiptar dhe 54687 banorë shtetas shqiptarë të nacionalitetit etnik jo shqiptar.⁷⁶

Numri i përgjithshëm i familjeve të rëluara nga regjistrimi ishte 463333, me mesatarisht 5.6 persona për familje.

Nga i gjithë numri i familjeve 20.5% kishin gjer në tre persona, 46.1% ishin 4-6 persona, 29.3% kishin 7-10 persona dhe 4.1% kishin 11 persona e lart.

Kundrejt vitit 1969, me përjashtim të familjeve me mbi 11 persona, që numri i tyre ka rënë, në të gjithë kategoritë e familjeve të tjera, ka rritje të numrit.

Po të vrojtohen ritmet e rritjes sipas numrit të pjesëtarëve për familje del se në vitet 1969-1979, ritmi është më i ulët për kategoritë me më shumë se 7 pjesëtarë dhe më i lartë për kategorinë me 4-6 pjesëtarë. Kjo shpjegohet me tendencën e kalimit në familje me një kurorë ose një bark, por që akoma karakterizohet nga niveli i lartë i riprodhimit natyror të familjes, sidomos në fshat ku numri mesatar i personave për një familje ishte 6.2 persona, dhe familjet me 4 pjesëtarë e lart zinin 44.6% të numrit të familjeve fshatare, kur në qytet kjo kategori zinte vetëm 20.3%.

7. Regjistrimi i popullsisë vitit 1989

Nga mesi i vitit 1986, Drejtoria e Statistikës në Komisionin e Planit të Shtetit merr në shqyrtim evolucionin e proceseve demografike në Shqipëri, cilësinë e regjistrimeve të kryera, si dhe nevojën e një rievimi të ri të popullsisë duke përdorur një metodologji sa më të përshtatshme. Mendimi për një rievim të ri të përgjithshëm të popullsisë aprovohet nga Kolegjiumi i Komisionit të Planit dhe me shkresë nr.293 datë 12.09.1986 i përcillet Këshillit të Ministrave. Mendimi për regjistrimin e ri të popullsisë, që ju dërgua Këshillit të Ministrave, përfshinte edhe relacionin me shkrim që argumentonte nevojën e regjistrimit të popullsisë, si dhe formularet e mundshëm që do të vireshin në përdorim gjatë regjistrimit. Në parashtresën që i bëhej Këshillit të Ministrave si kohë e mundëshme për regjistrimin e popullsisë propozohej viti 1989. Pas një miratimi në parim të organizimit të një procesi të tillë, Komisioni i Planit të Shtetit (në veçanti Drejtoria e Statistikës) filloi përgatitjet e nevojshme.

Ndër masat e para ishte dërgimi i një grupi pune në mars 1987 në Gjenevë (Zvicër) për t'u njohur me kërkesat dhe metodologjinë e vendeve Evropiane për regjistrime të tilla: të përgjithëshme, të hapura dhe me kërkesa të zgjeruara si për popullsinë edhe për banesat. Ndihma e organizmave ndërkombëtare synohej të ishte njëherësh metodologjike dhe teknike, sidomos gjatë përpunimit të materialit të rëluar. Në këtë drejtim ndihmoi:

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA). Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Kooperimin Teknik dhe Zhvillimin (UNDTCD) dhe Zyra e Statistikës së Kombeve të Bashkuara (UN Statistical Office).

Pajisjet e nevojshme teknike u siguruan me anën e "Projektmarrëveshjes midis Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në projektin ALB /89/PO 1, me titull "Regjistrimi i popullsisë e banesave 1989"⁷⁷

Kjo është hera e parë që shteti shqiptar synon të realizojë regjistrimin e popullsisë, mbështetur mbi një metodologji të re, e cila do të lejonte përdorimin e teknikës bashkëkohore në përpunimin e materialit të rilevuar dhe nxjerrjen e përfundimeve për një seri më të madhe strukturash.

Njëkohësisht Komisioni i Planit të Shtetit me shkresën e tij nr.116, datë 13.10.1987 u dërgon institucioneve kryesore qendrore projekt-vendimin e formuluar për regjistrimin e përgjithshëm dhe iu kërkonte atyre që të jepnin mendimet e sugjerimet e tyre.

Pasi u mblodhën mendimet e sugjerimet e dikastereve u formulua projektvendimi i rishikuar, i cili me shkresën nr.116/4, datë 02.12.1987 te Komisionit të Planit të Shtetit ju dërgua Këshillit të Ministrave për miratim.

Këtë projekt-vendim të Komisionit të Planit të Shtetit, Këshilli i Ministrave e mori në shqyrtim me datën 13.01.1988 dhe nxori vendimin nr.25, datë 13.01.1988, ku aprovohej kryerja e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë. Në këtë vendim si datë për realizimin e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë u përcaktua 2-8 prilli 1989.

Mbledhja e Këshillit të Ministrave më datë 13.02.1988, aprovon programin e punës për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë, si dhe fondin e shpenzimeve prej 500 mijë lekësh.⁷⁸ Më vonë u bë një shtesë prej 139 mijë lekësh, ndërsa shpenzimet përfundimtare shkuan në 800 mijë lekë

Kjo Mbledhje e Këshillit të Ministrave aprovoi edhe përbërjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit, me përfaqësues të po atyre dikastereve si dhe në regjistrimet e mëparshme. Krijimi i komisioneve sipas hallkave të organizimit territorial kishte po ashtu hierarkinë e përdorur në regjistrimet e mëparshme.

Për kryejën e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë i gjithë territori i vendit u nda në 1404 zona regjistrimi dhe në 19490⁷⁹ sektorë regjistrimi.

7.a. Dokumentet e regjistrimit të popullsisë

Dokumentet e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë më 2 prill 1989 përbëheshin nga dy grupe:

- * Udhëzuesit metodologjikë
- * Modularët e regjistrimit

7.a.1. Udhëzuesit metodologjikë

Të gjithë këta udhëzues u botuan në një broshurë dhe iu shpërndanë të gjithë punonjësve të regjistrimit.

Në broshurën e publikuar pasqyroheshin.

- * Vendimet për regjistrimin e popullsisë
- * Dispozita të përgjithshme
- * Dispozita të veçanta
- * Udhëzime të përgjithshme
- * Sqarime për përcaktimin e grupimeve shoqërore, për plotësimin e moduleve, radhën e punës, etj.

7.a.2. Modularët e regjistrimit

Në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë u përdorën 6 modularë, prej të cilëve 2 ishin lista përmbledhëse dhe një modular ishte i destinuar për vjeljen e të dhënave për banesat.

Mod. "A"- Fletë individuale me të njëjtat kërkesa si edhe ai i përdorur në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë më 7 janar 1979.

Mod. "B"- Fletë familje, ku përveç kërkesave të paraqitura në regjistrimin e mëparshëm u shtuan edhe kërkesat për te ardhurat monetare vjetore të familjes si dhe pajisjet elektroshtëpiake.

Mod. "C"- Kërkonte të dhëna në lidhje me banesën e familjes: koha dhe mënyra e ndërtimit, mënyra e furnizimit me ujë, gjendja e WC-së etj.

Mod. "K"- Listë përmbledhëse për banesat ku shënohej kryefamiljari, numri i dhomave (pa kuzhinën), sipërfaqja e banimit (pa kuzhinën), sipërfaqja e kuzhinës etj.

Mod. "S"- Listë përmbledhëse e ndërtesave dhe e familjeve që gjendeshin në sektorin e regjistrimit.

Mod. "Z"- Listë përmbledhëse e sektorëve që përmbante zona e regjistrimit të përgjithshëm.

7.b Rezultatet më të përgjithshme të regjistrimit në vitin 1989

Pas përfundimit të përpunimit⁸⁰ të të dhënave të rëluara nga regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i 2 prillit 1989, rezultoi një popullsi e përgjithshme prej 3182417 banorësh. Nga kjo popullsi 1638074 banorë kanë rezultuar të gjinisë mashkullore dhe 1544343 banorë të gjinisë femërore. Raporti gjinor ishte: 51.5% meshkuj dhe 48.5% femra.⁸¹

Kundrejt vitit 1979, e dhëna e regjistrimit, popullsia është rritur me 22.8% duke pasqyruar në të krejtësisht riprodhimin natyror. Vlerësuar sipas vendbanimit qytet-fshat të dhënat e regjistrimit paraqiten: 1137562 banorë urbane (35.7%) dhe 2044855 banorë ruralë (64.3%). Në popullsinë urbane struktura gjinore ishte 49.3% femra dhe 50.7% meshkuj, ndërsa në popullsinë rurale struktura gjinore ishte 48.1% femra dhe 51.9% meshkuj. Diferencimi gjinor ka të bëjë me strukturën gjinore të migrimit ku femrat, të larguara me martesë, zinin pozitë më të ndieshme se meshkujt, në qendrat urbane, këtë tregon edhe krahasimi i peshës së femrave në popullsinë e rëluar në vitin 1979 dhe në vitin 1989. Në këtë të fundit peshë është 0.3% më e madhe.

Numri i përgjithshëm i vendbanimeve urbane të përfshira në regjistrim ishte 67, ndërsa i vendbanimeve rurale ishte 2848.

Struktura moshore e popullsisë e rëluar nga regjistrimi i përgjithshëm ishte:

* Deri në 15 vjeç - 1050588 banorë (33.0%)

* 15-60 vjeç - 1883146 banorë (59.2%)

* 60 vjeç e lart - 248683 banorë (7.8%)

Krahasuar me vitin 1979, vihet re se grupmosha e re ka patur rënie të dukshme, duke u rritur ndjeshëm grupmosha e punës. Kjo ishte e lidhur me rënien e riprodhimit

natyror nga njëra anë dhe kalimin në grupmoshën e punës të breznive me kontigjent të ndieshëm, rezultat i riprodhimit shumë të zgjeruar të hasur gjatë viteve 60.

Nga të dhënat e regjistrimit rezultoi se popullsia në moshë pune⁸² zinte 57.6% të popullsisë së përgjithshme, kur krahët e aftë për punë zinin 52.3% të popullsisë së përgjithshme. Krahët e aftë për punë ishin aktivë 90.2% e numrit të tyre, ndërsa jo aktive 9.8% ose 156599 veta. Fuqia punëtore inaktive në masën 52% ishte e përqëndruar në qytete dhe 60.1% në elementin femër. Mosha mediane e popullsisë rezultoi 22.6%, kur për femrat ishte 22.9 vjeç dhe për meshkujt 22.3 vjeç. Për popullsinë qytetare mosha mediane ishte 25,9 vjeç dhe për popullsinë rurale ishte 20.8 vjeç.

Lidhur me përkatësinë e nacionalitetit etnik regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë më 2 prill 1989 rilevoi 3117601 banorë shtetas shqiptarë të nacionalitetit shqiptar dhe 64816 banorë shtetas shqiptarë të nacionalitetit joshqiptar.

Numri i përgjithshëm i familjeve të rilevuara në regjistrim ishte 675456 me mesatarisht 4.7 pjesëtarë secila. Nga numri i përgjithshëm i familjeve 42.8% ishin në qendrat urbane me mesatarisht 3.9 pjesëtarë secila dhe 57.2% në qendrat e banuara rurale me 5.3 pjesëtarë secila.

Të dhënat e regjistrimit vënë në dukje se është ulur ndjeshëm, sidomos në qendrat urbane, numri i familjeve me 7 pjesëtarë e lart, duke zënë gjithsej 17.3% të numrit të familjeve, kur në vitin 1979 zinin 33.4% të numrit të familjeve.

Zvogëlimi i numrit të pjesëtarëve në familje nuk është realizuar aq nga rënia e nivelit të riprodhimit, se sa nga arsye ekonomike. Në kushtet e racionimit të produkteve ushqimore familjet u ndanë për të përfituar sa më shumë. Kjo dukuri ndodhi si në qytet edhe në fshat.

Niveli i shkollimit, sipas të dhënave të regjistrimit për popullsinë mbi 10 vjeç që dinte shkrim e këndim rezultoi në 9.1 klasë. Në këtë popullsi (mbi 10 vjeç) me një kontigjent prej 2458063 personash 91.8% dinte shkrim e këndim dhe 8.2% ishte analfabete. Për femrat analfabetizmi ishte 11.8% e popullsisë femërore mbi 10 vjeç.

Sipas ndarjes qytet-fshat treguesi i analfabetizmit ishte respektivisht 4.6% dhe 9.8% ku në të dy këto hapësira femrat kishin një nivel respektiv analfabetizmi prej 7.4% dhe 14.4%.

MBRETNIJA

SHQIPTARE

Fletorja

Zyrtare

Botohet prej Ministrisë së P. të Mbrendshme

PAJTIME: për një mot fr.ar 12
në Shqipni ; fr. ar 20 jashta

Drejtimi: Drejtoria Fletore Zyrtare
TIRANË

Nji copë e javës fr.ar 0.25; nji
copë e javës së kalueshme fr.ar
1.00

PËRMBAJTJA:

Dekret-Ligjë mbi regjistrimin e Përgjithëm të Popullit.

Ligjë për krijimin e një fondi në budgetin 1929-30 të Ministrisë së Financës për shpërblim të Këshillit të Qeverisë pranë Shoqnis "Svea.". Ligjë mbi zbatimin e dytë t'afatit të kërkimeve të Shoqnis korçesjonare të voj-gurit D'Atcy Exploration C'LTD.

Këshilli Ministrues

Shpalljet e Gjyqeve.

Dekret-Ligjë**Mbi rregjistrimin e përgjithshëm të Popullsisë****Neni 1**

Në fillim të muajve Prill-Majë të vitit 1930 në Mbretnin Shqiptare do të bëhet regjistrimi i përgjithshëm i Popullsisë.

Neni 2

Formulimi i pyetjeve, të cilat populli detyrohet pa asnjë kundërshtim a pengim t'u japë përgjigjet e duhura, dhe marrja e të gjithë masave që do të vlejné për me sigurue plotësishtë rezultatin e dishëruem të regjistrimit popullsisë, do të caktohet, në model fletën për regjistrimin e popullsisë e cila do të përmbajë emrin e mbiemnin, Atësinë, Mëmësinë seksin e relacionin e gjinis, datë lindjen, vend lindjen, gjendjen civile, gjuhën amtare, e jo dialektin, gjuhët tjera qi di, banimin e përhershëm, nënshtetësin, mjeshtërinë dijenin e shkrimit e të këndimit, besimin, gjendjen trupore, rregjistrue tjetër herë, datën e letërnjoftimit të ma parshëm, pronësin, e farën e kësaj dhe shënimet Shtatit; qi do të shpjegohen me një qarkore shpjeguese të përgatitun prej Këshillit të Komisioni të posaçme qi formohet prej Ministris së P. të Mbrendëshme me vendim të Këshillit Ministrues tue u aprovuëm edhe qarkorja në fjala prej Këshillit të përmendun dhe tue u betue rregullishtë.

Art. 3

Për veç gjykatësve, të gjithë nëpunësit civil ose ushtarakë anëtarët e Këshillave

administrative të Prefekturave, Nënprefekturave, Kryetarët e Bashkive dhe Katundarive, anëtarët e këtyne Këshillave trupi arsimuer dhe gjithë nëpunësit e institucioneve publike qi paguhen prej fondeve të posaçme dhe gjithë ata gjytetas qi dinë me këndue e me shkruie detyrohen me pranue dhe me ekzekutue shërbimin qi do t'u ngarkohet prej autoriteteve administrative

Nxansit e Shkollave qi kanë një moshë ma të madhe se 16 vjetësh në rasë nevojë mund të detyrohen me shërbim rregjistrimi edhe për këtë shkak mund pushohen shkollat maksimum për një javë.

Me një vendim specifikues të Këshillit Ministrues mund të përjashtohen nga barra e nëpunësit së rregjistrimit; ata qi kanë të bënë me shërbimet e përgjithshme të sigurimit të post-telegrafeve ose ata qi mungesa e tyre provokon cënimin e jetës ekonomike të vendit.

Neni 4

Ata qi nuk do të pranojnë detyrat qi ngarkohen për të kryemit e rregjistrimit dhe ata qi shkelin dispozitat qi përmban qarkorja shpjeguese si mbas Nenit 2 denohen me gjoba që nga 25 deri 500 Fr. ari dhe gjithë ata persona nëpunës ose jo qi nxjerrin pengime për mos-pranimin e detyrës së ngarkueme prej autoriteteve kompetente ose që u kundërshtojnë veprimeve të regjistrimit ashtu ata persona qi nuk rregjistrojnë dhe fshehin antarët e familjes së tyre ose nuk deklarojnë pikrishtë moshën e gjithë gjendjen e antarëve të familjes së tyre dënohen me gjobë nga 50 deri 1000 Fr. ari

Vendimi i ndëshkimeve me gjobat e sipër-tregueme merret prej Komisionit të regjistrimit dhe ekzekutohet pa vones prej autoriteteve administrative të qarkut ku mbahet rregjistrimi. Vendimi në fjalë asht i pakundërshtueshëm dhe i pa diskutueshëm. Mbasi t'ekzekutohet, i dënuemi ka të drejtë me ju derjtue Gjykatës.

Neni 5

Ne raste qi gjobat e tregueme ma sipër nuk paguhen në nenin mbrenda 24 orëve, gjobat këmbehen me burgim, këmbimi i gjobës me burg i takon Prokurorit të Qarkut tue u bazue në Proces-verbalin e Komisionit rregjistrues, simbas dispozitave të Kodit Penal.

Neni 6

Fondi i nevojshme qi asht destinue për rregjistrimin e popullsis dhe qi nuk asht caktue ose do të caktohet në buxhetin e Ministris së P. të Mbrenshme do të shpenzohet me pagim djetesh, shpenzime rrugash personave të ngarkuem me shërbim kur merren nga jashtë dhe nëpunësve civil ose ushtarak kur dalin jashtë banesës ose qendrës së tyre.

Gjithashtu shpenzimet tjera të nevojitura për rregjistrimin paguhen prej këtij fondi.

Neni 7

Kjo Dekret Ligjë hynë në fuqi me datën e shpalljes në Fletoren Zyrtare

Neni 8

Me zbatimin e kësaj Dekret-Ligje ngarkohet Trupi Ministrues.

K r y e m i n i s t r i :
Ministri P. të Mbrendshme
Zav. Ministri i P. Jashtme
K. Kota d.v.
Ministri Drejtësie
H. Delvina d. v.

Ministri i Arsimit
Zav. Ministri i Financave
A. Dibra d. v.
Ministri i Ekonomisë Kombtare
M. Juka d. v.

Z O G U I.
Mbreti i Shqiptarëve

Mbi propozimin e Kryeministris Nr. 1203 IV datë 26. 08. 1929

Si ndigjoj dhe pëlqej vendimin e Këshillit Ministrues me datë 27. 09. 1929

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi rregjistrimin e përgjithshëm të popullsis.
Tiranë, më 7 Shtatuer 1929

ZOG d. v.

ZOGU I

Mbret i Shqiptarve

DEKRECION

Zbatimin e këtij Dekret-Ligji të aprovuem prej Parlamentit dhe urdhnon shtimin e tij
në Kodet e Mbretnis si Ligjë.
Tiranë më 15 Kollnuer 1930

ZOG d. v.

KRYESIJA E KËSHILLIT ANTIFASHIST N. ÇI.

V E N D I M

Nr. 119, datë 15.09.1945

Mbi rregjistrimin e përgjithshëm
të popullsisë**NENI 1**

Më datë 30.IX.1945 do të kryhet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë për efekt të zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese.

NENI 2

Për kryemjen e këtij regjistrimi do të mobilizohen të gjithë nëpunësit civilë, ushtarakë, anëtarët e Komiteteve Ekzekutive të Prefekturave e N. Prefekturave, anëtarët e Këshillave N. Ç. të lokaliteteve, trupi arsimor, të rinjtë, gratë, dhe gjithë nëpunësat e instituteve publike e parashtetnore që paguhen prej fondeve të posaçme si edhe gjithë nënshtetasit që dinë me shkruar e me këndue gjuhën amtare dhe që janë në gjendje me krye detyrën e nëpunësit të regjistrimit.

Në rast nevojë mund të mobilizohen edhe nxansit e shkollave që kanë një moshë ma të madhe se 16 vjeç.

Përfshihen nga detyra e nëpunësit të regjistrimit ata që kanë të bëjnë me shërbimet e përgjithshme të sigurimit, të post-telegrafave si edhe ata që me mungesën e tyre i shkaktojnë çrregullime jetës shoqërore dhe ekonomike të vendit

NENI 3

Me qarkore e broshura të veçanta do të jepen udhëzime të imta mbi mënyrën e kryemjes të regjistrimit për të bërë këtë që të japi frytet e dëshirueshme.

NENI 4

Kushdo që të sjelli kundërshtim ose pengime në regjistrim ose të japi njoftime që nuk i përgjigjen të vërtetës do të dënohet me gjobë të lehtë nga fr. shq. 2000 deri në 5000.

Gjithashtu kanë me u gjobue me fr. shq. 12000 ata që do të refuzojnë të kryejnë detyrën e nëpunësit të regjistrimit simbas nenit 2 të këtij Vendimi.

NENI 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

NENI 6

Këshilli Ministerial ngarkohet me zbatimin e këtij Vendimi.

Tiranë , më 15.09.1945

Për Kryesinë e Këshillit Antifashist N. Çl.

SEKRETARI:

KRYETARI:

DEKRET

Në mbështetje të nenit 58 nr. 5 të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë :

Pasi u votua nga Kuvendi Popullor.

Kryesia e Presidiumit të Kuvendit Popullor

SHPALL

Ligjën me titull e përmbajtje si vijon :

ligji i datës 5.7. 1959 mbi regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë.

Neni 1

Duke marrë parasysh se në pesë vitet e fundit në vendin tonë janë bërë ndryshime të mëdha në përbërjen e popullsisë, nga pikpamja numerike, shoqërore, kulturore, profesionale etj si dhe nevojën e krijimit të një regjistri themeltar të shtetasve më të përsosur, në mënyrë që ti përgjigjet konditave të sotme, autorizohet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë.

Regjistrimi do bëhet më 3 shtator 1950.

Neni 2

Veprimet e ndryshme të regjistrimit drejtohen dhe mbikqyren nga Komisioni Qëndror i emëruar me vendim të Këshillit Ministror dhe nga komisionet e posaçme që formohen pranë Komiteteve Ekzekutive të Këshillave Popullore të Rretheve, Qyteteve dhe Lokaliteteve.

Komisionet e Lokaliteteve dhe të qyteteve detyrohen që deri më 31 korrik 1950, të kontrollojnë dhe të plotësojnë emërtimin e shesheve dhe të rrugëve, të bëjnë numërimin progresiv të shtëpive dhe të ndajnë territorin e çdo fshati dhe qyteti në zona e sektorë regjistrimi.

Shpenzimet për numerimin definitiv të shtëpive do të paguhen nga pronarët e shtëpive kurse ato të shesheve nga KP të qyteteve.

Neni 3

Për të kryer veprimet e regjistrimit, Komitetet Ekzekutive të KP të Rretheve e Qyteteve mbi propozimin e Komisioneve të regjistrimit, që bëhët fjalë në nenin 2 emërojnë një numër të mjaftueshëm nëpunës të regjistrimit, që do të zgjidhen midis nëpunësve të ndryshëm civilë dhe ushtarakë, studentë dhe shtetasve të tjerë që çmohen të aftë për të kryer këtë detyrë.

Përfshihen nga detyra e nëpunësit të regjistrimit ata që kanë të bëjnë me shërbime të përgjithshme të sigurimit, telegrafistët, mjekët, si dhe ata që në mungesën e tyre shkaktajnë çrregullime në jetën ekonomike dhe shoqërore të vendit.

Neni 4

Regjistrimi do bëhet shtëpi më shtëpi në prezencë të personave që do të regjistrohen.

Ditën e regjistrimit është e ndaluar qarkullimi. Mund të qarkullojnë vetëm personat e pajisur me leje të posaçme të lëshuar nga komisionet e regjistrimit.

Neni 5

Çdo person madhor është i detyruar të regjistrojë veten e tij. Kryetari i familjes detyrohet të regjistrojë gjithë fëmijët e tij të mitur, personat që bashkëjetojnë me të dhe që janë në ngarkim të tij dhe personat që ditën e regjistrimit ndodhen në shtëpinë e tij.

Drejtorët e konvikteve, hoteleve, kantierëve, institucioneve të mjekimit dhe profilaksisë etj, detyrohen t'i deklarojnë nëpunësit të regjistrimit të gjithë personat që jetojnë në to.

Neni 6

Të gjithë personat duhet të vërtetojnë pranë nëpunësit të regjistrimit identitetin e gjendjen civile të tyre me letër njoftimi ose certifikatë lindje dhe dokumentin ushtarak. Ata që nuk janë pajisur me dokumenta të tilla duhet të kenë një certifikatë lindje, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile posaçërisht për qëllimin e regjistrimit.

Certifikatat për efekt të regjistrimit lëshohen nga zyra e gjendjes civile kundrejt një takse fikse lekë 2.

Shtetasit e huaj duhet të vërtetojnë identitetin e tyre me leje qëndrimi ose pasaportë.

Çdo person shtetas ose i huaj detyrohet gjithashtu t'u japë nëpunësve të regjistrimit të gjitha informatat që do t'i kërkohen për plotësimin e fletës së regjistrimit.

Neni 7

Modelet e fletës së regjistrimit dhe pyetjet që do të përmbajnë këto, caktohen nga Komisioni Qëndror për përgatitjen dhe drejtimin e regjistrimit.

Në fletën familjare në pjesë të veçanta do të regjistrohen si pjesëtarët e familjes që ndodhen prezent, ashtu dhe ato që ndodhen përkohësisht larg familjes ose dhe jashtë shtetit, qoftë dhe për një kohë të pacaktuar.

Neni 8

Regjistrimi i shtetasve që banojnë ose qëndrojnë përkohësisht jashtë shtetit bëhen nga përfaqësitë e Republikës Popullore të Shqipërisë ose nga shoqatat që do të autorizohen posaçërisht për këtë qëllim nga Këshilli Ministror.

Neni 9

1. Dënohen në bazë të ligjës mbi kundravajtje, me gjobë nga 500 deri 2 000 lekë ose me punë korrektonjëse deri më 2 muaj, në qoftë se refuzojnë të japin të dhënat e nevojshme ose japin informata të rreme për vete, për pjesëtarët e familjes.

të tyre ose për personat që strehojnë ditën e regjistrimit ose nuk paraqisin dokumentat e nevojshme për vete, për të miturit dhe për persona të pazotë që kanë nën kujdesin e tyre.

2. Personat që refuzojnë të kryejnë detyrën e nëpunësit të regjistrimit ose tregojnë pakujdesi në përmbushjen e kësaj detyre.

Neni 10

Autorizohet qeveria që për zbatimin e kësaj ligje të nxjerrë urdhëresa e rregullore.

Neni 11

Komisioni Qëndror i Regjistrimit autorizohet të nxjerrë udhëzime të detyrueshme për zbatimin e dispozitave të kësaj ligje.

Neni 12

Kjo ligjë hyn në fuqi ditën e shpalljes së saj në Gazetën Zyrtare.

Tiranë më 5 korrik 1950

Nr. i Dekretit 1112

RELACION MBI NEVOJËN E BËRJES SË NJË REGJISTRIMI TË PËRGJITHSHËM TË POPULLSISË NË VITIN 1955

Më 3 Shtator të këtij viti mbushen 5 vjet që u bë regjistrimi i fundit i përgjithshëm i popullsisë. Prej atëherë e deri sot në vendin tonë janë bërë ndryshime të mëdha në çdo fushë të aktivitetit ekonomik shoqëror e kultural. Këto ndryshime kanë bërë që në vendin tonë të krijohen qendra pune të rëndësishme duke ndryshuar kështu përbërjen e popullsisë të shumë viseve e krahinave. Ngritja e vazhdueshme tekniko-profesionale e punonjësve, vënia në shfrytëzim e industrive të reja kanë shkaktuar ndryshime rrënjësore midis profesioneve ekzistuese. Zhvillimi i vrullshëm i arsimit dhe kulturës kanë ndryshuar së tepërmi gjendjen kulturele të popullsisë. Me qëllim që të vihen më dukje ndryshimet e bëra brenda këtyre pesë vjetëve është nevoja të bëhet një regjistrim i ri i popullsisë.

Një arsye tjetër që na shtyn të kërkojmë të bëhet regjistrimi i ri i popullsisë është edhe përcaktimi numerik i popullsisë së vendit tonë. Dy regjistrimet e para (i vitit 1945 dhe ai i vitit 1950) që u bënë me qëllim për krijimin e regjistrave themeltarë dhe për qëllime statistikore kanë shkaktuar që të mos dilte i saktë numri i popullsisë. Kjo ndodhte për shkak se materiali i regjistrimit ka lëvizur nga një zyrë e gjendjes civile në tjetrën për t'u verifikuar dhe transkriptuar. Lëvizja e materialit ka shkaktuar humbjen e disa formularëve që, sipas mendimit tonë në vitin 1950 duhet të kenë qenë rreth 6000 copë.

Arsyeja e tretë që na shtyn të kërkojmë të bëjmë këtë regjistrim është edhe fakti që ne kemi sot një shërbim demografik të çalë, i cili bazohet në një sistem të vjetër të librave themeltarë, ku njerëzit nuk figurojnë të regjistruar sipas vendit ku punojnë dhe banojnë efektivisht, por sipas vend regjistrimit. Ndryshimet e ngjara mbas çlirimit në lidhje me lëvizjen e popullsisë nga një vend në një tjetër nuk sinjalizohen nga shërbimi i sotëm demografik dhe kjo e bën këtë të pavlefshëm. Mjafton të përmendim qytetin e Tiranës, i cili sipas Gjendjes Civile në fund të dhjetorit 1954 ka një popullsi prej rreth 68.800 frymësh, kurse sipas pasaportizimit janë rreth 105.000 frymë.

Është për t'u vënë në dukje dhe se të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të vitit 1950 si dhe ato të Gjendjes Civile nuk i përgjigjen ndarjes së sotme administrative.

Për të gjitha këto arsye dhe me qëllim që të krijohet një bazë e re e shëndoshë, e aftë që t'u përgjigjet kërkesave gjithnjë më të mëdha të planifikimit, mendojmë se duhet të bëhet një regjistrim i ri i popullsisë më datën 4 shtator 1955 duke shfrytëzuar për këtë regjistrim eksperiencën shumë të çmueshme të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracive popullore, me regjistrimin e ri mendojmë të rilevojme shumë më pak njoftime nga ai i vitit 1950 duke i dhënë krejtësisht karakter statistikor. Programi i këtij regjistrimi do të ketë rreth 30 pyetje dmth. 50% më pak nga ai i vitit 1950.

Nga regjistrimi i ri i popullsisë mendojmë të përpunojmë numrin e përgjithshëm të popullsisë sipas moshës, seksit dhe gjendjes civile. Një rëndësi e veçantë do t'i jepet profesionit dhe ushtrimit të tij sipas vjetërsisë profesionale dhe kategorisë së kualifikimit. Po kështu do të përpunohet numri i popullsisë sipas nivelit kultural,

sipas kombësisë, gjuhës dhe nënshtetësisë.

Për organizimin e këtij regjistrimi mendojmë t'i përmbahemi atij të vitit 1950, duke krijuar pranë Komisionit të Planit një Komision Qëndror, pranë Komiteteve Ekzekutive të kp të qarqeve komisione të posaçme organizimi dhe në rrethe, qytete e fshatra komisione zbatimi.

Me qëllim që regjistrimi të dalë i rregullt dhe pa të meta duhet që në të gjithë territorin e Republikës brenda datës 15 gusht 1955 nga ana e Komiteteve Ekzekutive të rretheve e qyteteve të bëhet emërtimi i rrugëve dhe numërimi i ndërtesave. Kjo punë paraprake është e domosdoshme.

Përpunimi i materialit të regjistrimit në mënyrë të hollësishme do të bëhet në Drejtorinë e Statistikave.

Shpenzimet e këtij regjistrimi do të kapin shumën aproksimative prej 4 milionë lekësh nga të cilat 3.5 milionë do t'i nevojiten Komisionit Qëndror për shtypjen e materialit të regjistrimit, për përpunimin e tij në qendër etj. dhe 500 mijë lekë do t'u nevojiten Komiteteve Ekzekutive të rretheve e qyteteve për të përballuar shpenzimet e numrimit të ndërtesave.

PRESIDENTI I KOMISIONIT TË PLANIT TË SHTETIT

Shkresa Nr. 90, dt. 24.2.55

Dakt. Z.P.

9/III/1955

KËSHILLI I MINISTRAVE**V E N D I M**

Nr. 182, më 31.5.1955

MBI**REGJISTRIMIN E POPULLSISË**

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, duke marrë parasysh se gjatë pesë vjetëve të fundit si rrjedhim i sukseseve të arritura në lëmin ekonomik, shoqëror dhe kultural, është ndryshuar përbërja e popullsisë dhe niveli profesional dhe kulturor i saj nga një anë dhe nga ana tjetër, duke marrë parasysh se shërbimi i sotshëm demografik nuk u përgjigjet kërkesave të planifikimit; me qëllim që të dali i saktë përcaktimi numerik i popullsisë dhe të krijohet një bazë e shëndoshë për ndjekjen e lëvizjes së popullsisë me evidenca korente në të ardhmen, në mbledhjen e datës 31.5.1955

V E N D O S i:

1 - Më 2 tetor 1955 ditën e dielë të bëhet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në të gjithë territorin e Republikës.

2. - Për organizimin e këtij regjistrimi, pranë Komisionit të Planit të Shtetit të krijohet një komision qendror i përbërë nga:

Presidenti i Komisionit të Planit të Shtetit	Kryetar
Zv./Presidenti " " "	Anëtar
Zv/ Ministri i P. të Brendshme	"
Zv/ Ministri i Mbrojtjes Popullore	"
Zv/ Ministri i Arsimit dhe Kulturës	"
Zv/ Ministri i Drejtësisë	"
Drejtori i Drejtorisë së Statistikave	"

Komisione të posaçme për regjistrimin e popullsisë të krijohen edhe pranë Komiteteve Ekzekutive të kp të qarqeve, rretheve dhe qyteteve nën drejtimin direkt të kryetarëve të këtyre komiteteve, të tilla komisione të krijohen gjithashtu edhe në fshatra dhe lagje.

Komisionet e qarqeve do të aprovohen nga Komisioni Qendror, ato të rretheve dhe qyteteve nga të qarqeve, ndërsa të fshatrave dhe lagjeve nga komisionet e rretheve dhe qyteteve kompetente.

3. - Komisionet e rretheve dhe të qyteteve detyrohen që brenda datës 15 gusht 1955 të kontrollojnë dhe të plotësojnë emërtimin e rrugëve dhe numërimin e regjistrimin e ndërtesave sipas udhëzimeve që do të jepen nga Komisioni Qendror.

4. - Për të kryer veprimet e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, komisionet e rretheve dhe të qyteteve të caktojnë nëpunësa regjistrimi dhe inspektorë zone, njerëz të aftë nga nëpunësit civilë ose ushtarakë, nga arsimtarët dhe studentët si

dhe nga persona të tjerë.

Përfshihen nga detyra e nëpunësit të regjistrimit ata që kanë të bëjnë me shërbime të përgjithshme të sigurimit: mjekët, telegrafistët, si dhe ata largimi i të cilëve nga detyra shkakton çrregullime në jetën ekonomike dhe shoqërore të vendit.

5. - Shtetasit që ditën e regjistrimit do të ndodhen me banim të përhershëm ose të përkohshëm jashtë shtetit do të regjistrohen nga Ministria e P. të Jashtme.

6. - Dënohen, sipas ligjit mbi kontravajtjet, me gjobë nga 500 gjer me 2000 lekë ose me punë korektonjëse gjer më dy muaj, në qoftë se vepra nuk formon krim:

a) ata që i shmangen regjistrimit, refuzojnë të japin të dhënat e nevojshme ose japin informata të rreme për vete, për pjestarët e familjes së tyre ose për personat që strehojnë ditën e regjistrimit ose nuk paraqesin dokumentat e nevojshme për vete, për të miturit dhe për persona të pazotë që kanë nën kujdesin e tyre;

b) ata që refuzojnë të kryejnë detyrën e nëpunësit të regjistrimit ose tregojnë pakujdesi në përmbushjen e kësaj detyre.

7. - Për të përballuar shpenzimet e këtij regjistrimi Ministria e Financave të verë në dispozicion të Komisionit Qëndror një fond prej 3.500.000 (tremilionë e pesëqind) lekësh dhe të komisioneve të qarqeve 500.000 (pesëqind mijë) lekë të tjera.

8. - Për nevojat e këtij regjistrimi Komisionit Qëndror i vihen në dispozicion 13 ton letër, ndërsa ndërmarrja shtetërore e botimeve, duke filluar nga muaji qershor, brenda muajit korrik 1955, të shtypë gjithë materialin e nevojshëm sipas kontratës që do të lidhet me Komisionin Qëndror të regjistrimit të popullsisë.

9. - Për kryerjen në rregull të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë Komisioni Qëndror që përmendet në pikën 1 të këtij vendimi, autorizohet që të nxjerrë udhëzime të detyrueshme.

10. - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH

KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 182, më 31.5.1955

MBI

REGJISTRIMIN E POPULLSISË

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, duke marrë parasysh se gjatë pesë vjetëve të fundit si rrjedhim i sukseseve të arritura në lëmin ekonomik, shoqëror dhe kulturor, është ndryshuar përbërja e popullsisë dhe niveli profesional dhe kulturor i saj nga një anë dhe nga ana tjetër, duke marrë parasysh se shërbimi i sotshëm demografik nuk u përgjigjet kërkesave të planifikimit; me qëllim që të dali i saktë përcaktimi numerik i popullsisë dhe të krijohet një bazë e shëndoshë për ndjekjen e lëvizjes së popullsisë me evidenca korente në të ardhmen, në mbledhjen e datës 31.5.1955

V E N D O S i:

1- Më 2 tetor 1955 ditën e dielë të bëhet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në të gjithë territorin e Republikës.

2. - Për organizimin e këtij regjistrimi, pranë Komisionit të Planit të Shtetit të krijohet një komision qëndror i përbërë nga:

Presidenti i Komisionit të Planit të Shtetit	Kryetar
Zv./Presidenti " " "	Anëtar
Zv/ Ministri i P. të Brendshme	"
Zv/ Ministri i Mbrojtjes Popullore	"
Zv/ Ministri i Arsimit dhe Kulturës	"
Zv/ Ministri i Drejtësisë	"
Drejtori i Drejtorisë së Statistikave	"

Komisione të posaçme për regjistrimin e popullsisë të krijohen edhe pranë Komiteteve Ekzekutive të kp të qarqeve, rretheve dhe qyteteve nën drejtimin direkt të kryetarëve të këtyre komiteteve, të tilla komisione të krijohen gjithashtu edhe në fshatra dhe lagje.

Komisionet e qarqeve do të aprovohen nga Komisioni Qëndror, ato të rretheve dhe qyteteve nga të qarqeve, ndërsa të fshatrave dhe lagjeve nga komisionet e rretheve dhe qyteteve kompetente.

3. - Komisionet e rretheve dhe të qyteteve detyrohen që brenda datës 15 gusht 1955 të kontrollojnë dhe të plotësojnë emërtimin e rrugëve dhe numërimin e regjistrimin e ndërtesave sipas udhëzimeve që do të jepen nga Komisioni Qëndror.

4. - Për të kryer veprimet e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, komisionet e rretheve dhe të qyteteve të caktojnë nëpunësa regjistrimi dhe inspektorë zone, njerëz të aftë nga nëpunësit civilë ose ushtarakë, nga arsimtarët dhe studentët si

dhe nga persona të tjerë.

Përfashtohen nga detyra e nëpunësit të regjistrimit ata që kanë të bëjnë me shërbime të përgjithshme të sigurimit: mjekët, telegrafistët, si dhe ata largimi i të cilëve nga detyra shkakton çrregullime në jetën ekonomike dhe shoqërore të vendit.

5. - Shtetasit që ditën e regjistrimit do të ndodhen me banim të përhershëm ose të përkohshëm jashtë shtetit do të regjistrohen nga Ministria e P. të Jashtme.

6. - Dënohen, sipas ligjit mbi kontravajtjet, me gjobë nga 500 gjer me 2000 lekë ose me punë korektonjëse gjer më dy muaj, në qoftë se vepra nuk formon krim:

a) ata që i shmangen regjistrimit, refuzojnë të japin të dhënat e nevojshme ose japin informata të rreme për vete, për pjestarët e familjes së tyre ose për personat që strehojnë ditën e regjistrimit ose nuk paraqesin dokumentat e nevojshme për vete, për të miturit dhe për persona të pazotë që kanë nën kujdesin e tyre;

b) ata që refuzojnë të kryejnë detyrën e nëpunësit të regjistrimit ose tregojnë pakujdesi në përmbushjen e kësaj detyre.

7. - Për të përballuar shpenzimet e këtij regjistrimi Ministria e Financave të verë në dispozicion të Komisionit Qëndror një fond prej 3.500.000 (tremilionë e pesëqind) lekësh dhe të komisioneve të qarqeve 500.000 (pesëqind mijë) lekë të tjera.

8. - Për nevojat e këtij regjistrimi Komisionit Qëndror i vihen në dispozicion 13 ton letër, ndërsa ndërmarrja shtetërore e botimeve, duke filluar nga muaji qershor, brenda muajit korrik 1955, të shtypë gjithë materialin e nevojshëm sipas kontratës që do të lidhet me Komisionin Qëndror të regjistrimit të popullsisë.

9. - Për kryerjen në rregull të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë Komisioni Qëndror që përmendet në pikën 1 të këtij vendimi, autorizohet që të nxjerrë udhëzime të detyrueshme.

10. - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH

Relacion

Mbi bërjen e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë në vitin 1960

Në tetor të këtij viti mbushen 5 vjet nga bërja e regjistrimit të fundshme të popullsisë. Gjatë kësaj kohe janë bërë ndryshime të mëdha në lëmin ekonomik, shoqëror dhe kulturor, janë krijuar qendra pune të reja dhe ka patur një lëvizje mjaft të madhe të popullsisë nga fshati në qytet. Me qëllim që të vihen në dukje këto ndryshime dhe të bëhet një studim shkencor i përbërjes së sotme të popullsisë është e domosdoshme që të bëhet një regjistrim i ri.

Nga Organizata e Kombeve të Bashkuara më 1956, dhe në veçanti nga grupi i punës i staticienëve në mars 1957, u ngrit si një detyrë për të gjithë shtetet që të përsëritet regjistrimi i popullsisë më 1960 ose të paktën nga viti 1959 gjer më 1961, me qëllim që, të dilej me një studim të përbashkët. Në kampin tonë u krye ky regjistrim vjet nga BS dhe u morën vendime edhe në RD Gjermane, në Hungari dhe në Poloni; bëhen përgatitje në Rumani e Bullgari, por nuk dimë se në çfarë kohe do të bëhet regjistrimi në këto vende.

Ky projekt vendim iu dërgua Ministrisë së Mbrojtjes, të Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Arsim-Kulturës, Financës dhe Drejtorisë së Ekonomisë Komunale, të cilat janë dakort me propozimin tonë. Vërejtjet e tyre u morën parasysh me përjashtim të Ministrisë së Financave që kërkon të ulë fondin e shpenzimeve në 6 milionë lekë dhe të mos jepet shpërblimi i njehershëm për drejtuesit e zyrave të regjistrimit të rretheve. Me këto vërejtje nuk jemi dakort për këto arsye:

1/ Numri i popullsisë nga tetori i 1955 në tetor 1960 rritet afërsisht 16%

2/ Volumi i përpunimit të njoftimeve shtohet rreth 33%

3/ Rroga e nëpunësve provizorë rritet nga 4000 lekë që ishte më 1955 në 4800 lekë apo 20% në muaj për efekt të heqjes së triskave

Vetëm për efekt të përpunimit ne na del se duhej të shtonim fondin e shpenzimeve rreth 2,7 milionë lekësh apo 50% kundrejt vitit 1955, kurse ne do të bëjmë të gjitha përpjekjet për t'a kryer regjistrimin me 7.25 milionë lekësh apo rreth 1 milionë lekë kursimi.

Tiranë më, 13.5.1960

KËSHILLI I MINISTRAVE VENDIM

Nr. 255 më 1. 6. 1960

MBI REGJISTRIMIN E PËRGJITHSHËM TË POPULLSISË

Këshilli i Ministrave, duke marrë parasysh se përbërja dhe niveli kultural dhe tekniko-profesional i popullsisë sonë ka ndryshuar shumë këto pesë vjetët e fundit, krahas sukseseve të mëdha të arritura në lëmin ekonomik, shoqëror e kultural, në mbledhjen e datës 1. 6. 1960

VENDOSI:

1/ Në muajin tetor të vitit 1960, të bëhet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në të gjithë territorin e Republikës.

2/ Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

K Ë S H I L L I I M I N I S T R A V E

V E N D I M

Nr. 383, Më 24. 8. 1960

MBÍ REGJISTRIMIN E POPULLSISË

Këshilli i Ministrave, duke marrë parasysh se përbërja dhe niveli kultural e tekniko-profesional i popullsisë sonë ka ndryshuar shumë këto pesë vjetët e fundit, me sukseset e mëdha të arritura në lëmin ekonomik, shoqëror e kultural, në mbledhjen e datës 24. 08. 1960.

V E N D O S I :

1/ Më datën 2 tetor 1960, ditën e diel, të bëhet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në të gjithë territorin e Republikës.

2/ Ditën e regjistrimit ndalohet qarkullimi i popullsisë, me përjashtim të njerëzve, mungesa e të cilëve mund të shkaktojë çrregullime në jetën ekonomike dhe shoqërore të vendit. Këta do të pajisen me leje të posaçme qarkullimi nga komisionet e regjistrimit.

3/ Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë përfshin gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj, që ndodhen për çdo arsye, në territorin e Republikës ditën e regjistrimit. Përjashtohet vetëm personeli i përfaqësive diplomatike të akredituar në vendin tonë si dhe pjesëtarët e familjeve të tyre.

4/ Organizimi, drejtimi dhe kryerja e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë i ngarkohet Komisionit Qëndror të Regjistrimit, që krijohet pranë Drejtorisë së Statistikës, me këtë përbërje;

a) Drejtori i Drejtorisë së Statistikës	Kryetar
b) Zv/Ministri i Ministrisë Mbrojtjes Popullore	Anëtar
c) Zv/Ministri i Ministrisë Punëve të Brendshme	"
ç) Zv/Ministri i Ministrisë së Drejtësisë	"
d) Zv/Ministri i Ministrisë Arsimit-Kulturës	"
dh) Drejtori i Drejtorisë Ekonomisë Komunale	"

Komisione të posaçme për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë krijohen pranë Komiteteve Ekzekutive të Këshillave Popullore të rretheve e të lokaliteteve, nën drejtimin e drejtpërdrejtë të kryetarëve të këtyre komiteteve. Të tilla komisione krijohen, gjithashtu edhe në fshatra e lagje.

5/ Pranë komisionit të regjistrimit të çdo rrethi krijohet zyra e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, në krye të së cilës emërohet një njeri i aftë, i shkëputur nga çdo punë tjetër. Me këtë detyrë ngarkohet një nëpunës nga aparati i Komitetit ekzekutiv. Kjo zyrë fillon veprimtarinë e saj nga data 15 korrik 1960 gjer më 30 tetor 1960 dhe varet drejtpërdrejt nga Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit. Në asnjë mënyrë nuk duhet të vihet në krye të kësaj zyre ekonomisti i zyrës së statistikës.

6/ Për të kryer veprimet e regjistrimit, Komitetet Ekzekutive të Këshillave Popullore të Rretheve, mbi propozimin e komisioneve të regjistrimit, emërojnë nëpunësa regjistrimi dhe inspektorë zonash njerëz të aftë, nga radhët e arsimtarëve, nëpunësve civilë e ushtarakë, nga studentët, si dhe nga njerëz të tjerë.

7/ Të gjitha organet shtetërore dhe shoqërore të mos pengojnë, në asnjë mënyrë, punonjësit e aparateve të tyre, që do të caktohen si nëpunës regjistrimi ose si inspektorë zonash.

8/ Nëpunësit e regjistrimit shkëputen nga puna e tyre kryesore për 6 ditë dhe inspektorët e zonave për 20 ditë, sipas planit kalendarik që do të caktojë Komisioni Qendror i Regjistrimit, pa humbur të drejtën e pagës.

9/ Për t'u bërë ballë shpenzimeve lidhur me punën përgatitore, kryerjen e regjistrimit dhe përpunimin e materialeve, Drejtorisë së statistikës, nga fondi rezervë i qeverisë, i jepen lekë 6.450.000 (gjashtë milion e katërqind e pesëdhjetëmijë) dhe komisioneve të rretheve lekë 800.000 (tetëqindmijë).

10/ Për kryerjen në rregull të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, Komisioni Qendror i Regjistrimit lejohet të nxjerrë udhëzime të detyrueshme, që duhet të zbatohen nga të gjitha organet shtetërore dhe shoqërore.

11/ Njerëzit që nuk japin të dhëna të sakta që kërkohen për regjistrimin, ata të caktuar për regjistrimin e popullsisë që kundërshtojnë të kryejnë këtë shërbim ose e kryejnë me të meta, si dhe njerëzit që pengojnë kryerjen e regjistrimit, dënohen sipas procedurës së parashikuar nga neni 24 të rregullores nr. 14, datë 28.1.1953: "Mbi kompetencat e shërbimit statistikor", me gjobë gjer më 2.000 lekë.

RELACION⁸²

Mbi

nevojën e bërjes së regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë në vitin 1965

Në tetor të këtij viti mbushen 5 vjet nga kryerja e regjistrimit të fundit të popullsisë. Ky do të ishte regjistrimi i pestë që bëjmë pas çlirimit. Një rregull ndërkombëtar mbi afatet ndërmjet dy regjistrimeve nuk ka. Disa shtete i kanë bërë si në çdo 5 vjet, të tjerët çdo 8 ose 10 vjet, sipas kushteve dhe nevojave që kanë patur.

Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror i vendit tonë ka bërë që të ndryshojë mjaft numri e përbërja socialo- kulturore e popullsisë, të cilat i kemi vështirë t'i parashikojmë.

Në vendet e tjera treguesi i rritjes së popullsisë ngrihet për 5-8 vjet mbas çdo lufte të madhe dhe pastaj bie, kurse tek ne gjer në vitin 1960, ka ndjekur tendencën e kundërt, gjë që na e ka bërë të vështirë llogaritjen prespektive të popullsisë.

Lëvizja e madhe e popullsisë nga fshati në qytet e rriti popullsinë qytetare në mënyrë të pa parë në periudhat ndërmjet regjistrimeve: 1945-1950, 4,6 përqind, 1950-1955 53,4 dhe 1955-1960 31,1 përqind. Në kushtet e kësaj lëvizje të madhe të popullsisë, që ka vazhduar edhe gjatë 4 vjetëve të 5 vjeçarit të tretë, ne nuk jemi në gjendje që të parashikojmë me saktësi numrin e popullsisë fshatare e qytetare që do të jetë në fund të vitit 1965.

I domosdoshëm do të jetë regjistrimi i ri gjithashtu për të pasqyruar ndryshimet në përbërjen shoqërore të popullsisë dhe veçanërisht të asaj aktive, parashikimi i të cilave është shumë i vështirë mbasi ka të bëjë me shumë faktorë. Kështu në vitin 1960, në parashikimin tonë, klasa punëtore duhej të përbënte 22.5 përqind të popullsisë, kurse në fakt, nga regjistrimi i vitit 1960 doli se kjo shifër ishte 29,7 përqind.

Vetëm nëpërmjet regjistrimit të ri do të mund të dalë shkalla arsimore e popullsisë, gjendja e analfabetizmit, llogaritja me saktësi e treguesit të zgjatjes mesatare të jetës së popullit etj.

Për llogaritjen dhe planifikimin e mjaft treguesëve të rëndësishëm ekonomiko-shoqëror sikundër janë hartimi i bilancit të fuqisë punëtore si republikë dhe sipas rretheve, furnizimi me bukë i popullsisë fshatare, të ardhurat reale të fshatarsisë, konsumi i artikujve ushqimorë dhe industriale për frymë të popullsisë qytetare e fshatare, kontigjenti i rekrutëve dhe zboristëve, kontigjenti i nxënësve, nevojat për banesa etj. janë të domosdoshme treguesit e lartë të përmendur të popullsisë, të cilët llogariten me saktësi vetëm nëpërmjet regjistrimeve.

Mendojmë që regjistrimin e ri të popullsisë ta bëjmë përsëri me ndalim qarkullimi, sepse kështu duhet një kohë më e shkurtër për kryerjen e tij, me pak nëpunësa regjistrimi dhe për një kohë vetëm prej 5 ditësh, kurse me të hapurin duhet një kohë e dyfishtë, duhen dyfish shpenzime për djeta dhe ka shumë rrezik që të mbeten njerëz pa u regjistruar. Do të bëjmë çmos që regjistrimin e datës 3 tetor 1965, ta përfundojmë sa më shpejt, për ta lënë popullin të lirë. Nuk do të

pengohen aspak nga puna të gjithë ata persona, mungesa e të cilëve shkakton çrregullime në jetën ekonomike dhe shoqërore të vendit.

Projekt-vendimi iu dërgua për vërejtje Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, të Punëve të Brendshme, të Arsimit dhe Kulturës të Drejtësisë, të Financës dhe të Ekonomisë Komunale. Vërejtjet e tyre u morën parasysh. Aparati i Komitetit Qendror të PPSH është gjithashtu dakord në rast se gjykohet e arsyeshme nga Këshilli i Ministrave.

PRESIDENTI KOMISIONIT PLANIT SHTETIT

PROJEKT - VENDIM

MBI

regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë

Duke marrë parasysh se përbërja dhe niveli kulturor e tekniko-profesional i popullsisë sonë ka ndryshuar shumë këto 5 vjetët e fundit me sukseset e mëdha të arritura në lëmin ekonomik, shoqëror e kultural, Këshilli i Ministrave në mbledhjen e datës _____

V e n d o s i

1 / Më datën 3 Tetor 1965, ditën e dielë, të bëhet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në të gjithë territorin e Republikës Popullore të Shqipërisë.

2 / Regjistrimi do të bëhet shtëpi më shtëpi me paraqitjen direkte të çdo personi.

3 / Ditën e regjistrimit ndalohet qarkullimi i popullsisë, me përjashtim të njerëzve, mungesa e të cilëve shkakton çrregullime në jetën e përditshme ekonomike dhe shoqërore të vendit. Këto persona të pajisen me leje të posaçme qarkullimi nga komisionet e regjistrimit.

4 / Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë përfshin të gjithë shtetasit shqiptarë e të huaj, që ndodhen prezent brenda territorit të Republikës Popullore të Shqipërisë ditën e regjistrimit. Përjashtohet vetëm personeli i përfaqësive të huaja të akredituara në vendin tonë, si dhe pjesëtarët e familjeve të tyre.

5 / Organizimi, drejtimi dhe kryerja e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë i ngarkohet Komisionit Qëndror të Regjistrimit që krijohet pranë Drejtorisë së Statistikës me këtë përbërje:

a) Drejtor i Drejtorisë së Statistikës ...	Kryetar
b) Zv/Ministri i Ministrisë Mbrojtjes Popullore...	Anëtar
c) Zv/Ministrisë i Ministrisë Punëve Brendshme...	Anëtar
ç) Zv/ Ministrisë i Ministrisë Arsimit dhe Kulturës	Anëtar
d) Zv/ Ministrisë i Ministrisë së Drejtësisë	Anëtar

Komisione të posaçme për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë të krijohen pranë Komiteteve Ekzekutive të KP të rretheve e lokaliteteve nën drejtimin direkt të kryetarëve të këtyre komiteteve. Të tilla komisione krijohen gjithashtu edhe në fshatra e lagje.

6 / Komisionet e regjistrimit të rretheve detyrohen që brenda muajit qershor të kontrollojnë dhe të plotësojnë emërtimin e rrugëve, numërimin e ndërtesave sipas udhëzimeve që do të lëshojë Drejtoria e Statistikës.

7 / Pranë Komisionit të regjistrimit të çdo rrethi të krijohet zyra e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, në krye të së cilës të emërohet një person i aftë i shkëputur nga çdo punë tjetër. Kjo zyrë të funksionojë që nga data 16 Qershor gjer më datën 30 Tetor 1965 dhe të varet direkt nga kryetari i Komitetit Ekzekutiv i K P të rrethit.

8 / Për të kryer veprimet e regjistrimit, Komitetet Ekzekutive të k.p. të rrethave, me propozimin e komisioneve të regjistrimit të emërojnë nëpunës regjistrimi dhe inspektorë zonash, njerëz të aftë nga rradhët e nëpunësve, arsimtarëve, studentëve, si dhe persona të tjerë. Përfshihen nga detyra e nëpunësit të regjistrimit të gjithë ata persona, largimi i të cilëve nga detyra e tyre kryesore shkakton çrregullime në jetën ekonomike dhe shoqërore të vendit.

9 / Të gjitha organet shtetërore dhe shoqërore nuk duhet të pengojnë në asnjë mënyrë punonjësit e aparateve të tyre, që do të caktohen si nëpunës regjistrimi ose si inspektorë zonash.

10 / Nëpunësit e regjistrimit të përgjithshëm të shkëputen nga puna e tyre kryesore për 5 ditë dhe dhe inspektorët e zonave për 20 ditë, sipas planit kalendarik që do të caktojë Komisioni Qëndror i Regjistrimit, pa humbur të drejtën e pagës.

11 / Për efekt të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë gjatë muajve maj-nëntor të vitit 1965, të mos bëhen ndryshime në kufi midis njësive administrative.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE
KRYESIA E KESHILLIT TE MINISTRAVE

PROJEKT-VENDIM

MBI

REGJISTRIMIN E PERGJITHSHEM TE POPULLSISE

Kryesia e Këshillit të Ministrave, duke marrë parasysh se përbërja shoqërore arsimore, kulturore, tekniko-profesionale etj. e popullsisë sonë ka ndryshuar shumë këta tetë vjetët e fundit nga përparimet e mëdha që janë arritur në të gjithë fushat e jetës dhe me qëllim që të pasqyrohen të gjitha këto ndryshime dhe mbi bazën e gjendjes së re që është krijuar, të bëhen studime të mëtejshme,

V e n d o s i:

1 / Brenda periudhës 30 mars-13 prill 1969 të bëhet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në të gjithë territorin e Republikës.

2 / Për organizimin dhe drejtimin e përgjithshëm të regjistrimit të popullsisë ngarkohet Komsioni i Planit të Shtetit (Drejtoria e Statistikës);

3 / Për organizimin dhe drejtimin e drejtë për drejt të regjistrimit në rrethe ngarkohen Komitetet Ekzekutive të KP të rretheve, të cilët ta kryejnë këtë punë sipas udhëzimeve të njejta që do të lëshojë Komisioni i Planit të Shtetit (Drejtoria e Statistikës);

4 / Për të përballuar shpenzimet që nevojiten për regjistrimin t'i jepet Komisionit të Planit të Shtetit një fond prej 800 mijë lekësh, nga i cili 200 mijë lekë nga fondi rezervë i qeverisë për vitin 1968.

5 / Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Kulturës që brenda muajit dhjetor 1968, të shtypi të gjitha pasqyrat që do të nevojiten për regjistrimin e popullsisë.

6 / Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PER KRYESINE E KESHILLIT TE MINISTRAVE

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 134 dt. 8.9.1968

MBI

REGJISTRIMIN E PËRGJITHSHËM TË POPULLSISË

Këshilli i Ministrave, duke marrë parasysh se përbërja shoqërore, arsimore, kulturore, tekniko-profesionale etj. e popullsisë tonë ka ndryshuar shumë këta tetë vjetët e fundit, si pasojë e përparimeve të mëdha që janë arritur në të gjitha fushat e jetës dhe me qëllim që këto ndryshime të pasqyrohen dhe, mbi bazën e gjendjes së re që është krijuar, të bëhen studime të mëtejshme,

V E N D O S I:

1. Brenda datës 30 mars - 13 prill të bëhet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në të gjithë territorin e Republikës.

2. Për organizimin dhe drejtimin e regjistrimit të popullsisë ngarkohet Komisioni i Planit të Shtetit (Drejtoria e Statistikës) dhe Komitetet Ekzekutive të Këshillave Popullore të Rretheve.

3. Për të përballuar shpenzimet që nevojiten për regjistrimin t'i jepet Komisionit të Planit të Shtetit një fond prej 800 mijë lekësh, nga i cili 200 mijë lekë nga fondi rezervë i Qeverisë për vitin 1968.

